



REPUBLIKA E SHQIPËRISË
KOMISIONI I PAVARUR I KUALIFIKIMIT

Nr. 286 Akti

Nr. 354 Vendimi
Tiranë, më 5.3.2021

V E N D I M

Trupi gjykues i Komisionit të Pavarur të Kualifikimit, i përbërë nga:

Suela Zhegu	Kryesuese
Lulzim Hamitaj	Relator
Etleda Çiftja	Anëtare

asistuar nga sekretarja gjyqësore, znj. Orjanda Liçi, në prani edhe të vëzhguesit ndërkombëtar, z. Branko Hrvatini, në datën 3.3.2021, në Pallatin e Koncerteve (ish-Pallati i Kongreseve), salla B, kati 0 (*underground*), Tiranë, mori në shqyrtim në seancë dëgjimore publike çështjen që i përket:

SUBJEKTI I RIVLERËSIMIT: **Znj. Ledina Lera**, me detyrë prokurore në Prokurorinë pranë Gjykatës së Rrethit Gjyqësor Tiranë.

OBJEKTI: **Rivlerësimi kalimtar i subjektit të rivlerësimit.**

BAZA LIGJORE: **Neni 179/b dhe nenet A, Ç, D, DH dhe E të Aneksit të Kushtetutës së Republikës së Shqipërisë**, miratuar me ligjin nr. 76/2016, datë 22.7.2016, “Për disa shtesa dhe ndryshime në ligjin nr. 8417, datë 21.10.1998, “Kushtetuta e Republikës së Shqipërisë”, i ndryshuar;

Ligji nr. 84/2016, “Për rivlerësimin kalimtar të gjyqtarëve dhe prokurorëve në Republikën e Shqipërisë”;

Ligji nr. 44/2015, “Kodi i Procedurave Administrative të Republikës së Shqipërisë”;

Ligji nr. 49/2012, “Për organizimin dhe funksionimin e gjykatave administrative dhe gjykimin e mosmarrëveshjeve administrative”, i ndryshuar.

TRUPI GJYKUES I KOMISIONIT TË PAVARUR TË KUALIFIKIMIT,

pasi dëgjoji arsyetimin ligjor dhe rekomandimin e relatorit të çështjes, subjektin e rivlerësimit, vëzhguesin ndërkombëtar, si dhe pasi shqyrtoi dhe diskutoi mbi tërësinë e çështjes që i përket rivlerësimit kalimtar të subjektit të rivlerësimit, znj. Ledina Lera, me detyrë prokurore në Prokurorinë pranë Gjykatës së Rrethit Gjyqësor Tiranë, e cila në seancën dëgjimore publike të datës 3.3.2021, kërkoi konfirmimin e saj në detyrë,

V Ë R E N:

I. RRETHANAT E ÇËSHTJES

- i. Znj. Ledina Lera ka dorëzuar dokumentacionin e kërkuar në zbatim të ligjit nr. 84/2016, në: Inspektoratin e Lartë të Deklarimit dhe Kontrollit të Pasurive dhe Konfliktit të Interesave (në vijim ILDKPKI); Drejtorinë e Sigurimit të Informacioneve të Klasifikuara (në vijim DSIK); dhe në Këshillin e Lartë Gjyqësor (në vijim KLGJ).
- ii. Pika 4, e nenit 179/b, të Aneksit të Kushtetutës së Republikës së Shqipërisë, miratuar me ligjin nr. 76/2016, datë 22.7.2016, “Për disa shtesa dhe ndryshime në ligjin nr. 8417, datë 21.10.1998, “Kushtetuta e Republikës së Shqipërisë”, i ndryshuar, parashikon se: *“Të gjithë gjyqtarët dhe prokurorët në detyrë [...] do të rivlerësohen, ex officio”*. Në këto kushte, ka filluar procedura e rivlerësimit për subjektin e rivlerësimit, znj. Ledina Lera.
- iii. Bazuar në pikën 2, të nenit 14, të ligjit nr. 84/2016 dhe në rregulloren “Për procedurat e zhvillimit të shortit në Komisionin e Pavarur të Kualifikimit”, Komisioni i Pavarur i Kualifikimit (në vijim Komisioni), ka hedhur shortin në datën 15.3.2019, nga i cili rezultoi se për subjektin e rivlerësimit, znj. Ledina Lera, procesi i rivlerësimit do të kryhej nga trupi gjykues, i përbërë nga komisionerët Lulzim Hamitaj, Suela Zhegu dhe Genta Tafa, (Bungo). Në datën 19.4.2019, komisionere Genta Tafa (Bungo) ka paraqitur dorëheqjen nga rivlerësimi i këtij subjekti. Trupi gjykues i shortuar për shqyrtimin e dorëheqjes në fjalë, e pranoi këtë të fundit, me vendimin e datës 6.5.2019. Për rrjedhojë, në respektim të rregullores së Komisionit, znj. Genta Tafa (Bungo) është zëvendësuar nga komisionere Etleda Çiftja, e cila rezultonte të ishte përzgjedhur si zëvendësuese e kësaj trupe (nr. 2), me shortin e datës 15.3.2019.
- iv. Trupi gjykues i lartpërmendur, pasi administroi dhe analizoi të tria raportet e përcjella nga organet ndihmëse, sipas parashikimeve të neneve 31 – 44, të ligjit nr. 84/2016, me vendimin nr. 1, datë 15.3.2019, vendosi: (i) të fillojë hetimin administrativ të thelluar dhe të gjithanshëm sipas nenit 45 të po këtij ligji; (ii) me mirëkuptim, të caktojë kryesuesin e trupit gjykues, komisioneren Suela Zhegu, gjithashtu, anëtarët e trupit gjykues deklaruan se nuk ishin në kushtet e konfliktit të interesit me subjektin e rivlerësimit në fjalë.
- v. Në vlerësim të provave të administruara përgjatë procesit të rivlerësimit për subjektin Ledina Lera, trupi gjykues, me vendimin nr. 2, datë 15.2.2021, vendosi të mbyllë fazën e hetimit administrativ dhe në bazë të nenit 4 të ligjit nr. 84/2016, të çmojë që procesi i rivlerësimit për këtë subjekt të bazohet në të tria kriteret e rivlerësimit, të parashikuara nga ligji nr. 84/2016.
- vi. Në datën 15.2.2021, Komisioni e njoftoi subjektin e rivlerësimit mbi: rezultatet e hetimit kryesisht – duke e ftuar për të sjellë shpjegime dhe prova të mundshme për të provuar të kundërtën e barrës së provës – për t’u njohur me provat e administruara nga Komisioni, në përputhje me nenin 47 të ligjit nr. 84/2016, si dhe me nenet 35 – 40 dhe

45 – 47, të Kodit të Procedurave Administrative, duke i dhënë kohë për t'u njohur me dosjen dhe për të paraqitur shpjegimet.

- vii. Subjekti i rivlerësimit, pasi u njoh me dosjen përkatëse në Komision, ka kërkuar kohë shtesë për shkaqe objektive, që i është dhënë nga trupa, dhe ka paraqitur shpjegimet dhe parashtrimet e tij, brenda afatit të ricaktuar, të shoqëruara me dokumentacion mbështetës, mbi rezultatet e hetimit kryesisht.
- viii. Gjithashtu, në datën 26.2.2021, trupi gjykues, me vendimin nr. 3, vendosi të ftojë subjektin e rivlerësimit në seancën dëgjimore të datës 3.3.2021, duke e njoftuar përmes postës elektronike, në përputhje me nenin 55 të ligjit nr. 84/2016.

II. SEANCA DËGJIMORE

- i. Seanca dëgjimore për subjektin e rivlerësimit, znj. Ledina Lera, u zhvillua në përputhje me kërkesat e nenit 55 të ligjit nr. 84/2016, në prani edhe të vëzhguesit ndërkombëtar, z. Branko Hrvatit, si dhe me pjesëmarrjen e subjektit të rivlerësimit.
- ii. Në vijim, pasi dëgjoi relacionin e Komisionit, znj. Ledina Lera, ka parashtruar shpjegimet përkatëse lidhur me rezultatet e hetimit kryesisht, si dhe mbi procesin e rivlerësimit të kryer ndaj saj, të cilat i ka paraqitur edhe me shkrim, së bashku me dokumentacionin provues përkatës. Gjithashtu, përgjatë seancës dëgjimore është pyetur dhe është dëgjuar edhe bashkëshorti i subjektit, i cili ishte përshkruar nga subjekti si njohës shumë më i mirë se ajo, jo vetëm i fushës financiare e tatimore, por edhe më në gjendje se subjekti i rivlerësimit për të paraqitur përpara trupit gjykues shpjegime tekniko-legjislative, në cilësinë e një eksperti, duke dhënë shpjegime që lidheshin drejtpërdrejt me deklaratimet, të ardhurat, shpenzimet dhe kursimet e përbashkëta.
- iii. Në fund të seancës dëgjimore, subjekti i rivlerësimit, znj. Ledina Lera, kërkoi konfirmimin në detyrë.
- iv. Seanca dëgjimore e datës 3.3.2021 u mbyll, për të rifilluar më 5.3.2021 për shpalljen e vendimit.

III. QËNDRIMI I SUBJEKTIT TË RIVLERËSIMIT

Subjekti i rivlerësimit ka qenë bashkëpunues në procesin e rivlerësimit, duke u përgjigjur në kohë, kur i është kërkuar, sipas nenit 48 të ligjit nr. 84/2016, përgjatë gjithë procedurës së hetimit administrativ kryesisht.

IV. HETIMI ADMINISTRATIV I KRYER NGA KOMISIONI

Bazuar në nenet 45, 49 dhe 50 të ligjit nr. 84/2016, Komisioni kreu një hetim dhe vlerësim të të gjitha fakteve dhe rrethanave të nevojshme për procedurën e rivlerësimit, duke marrë në analizë: (i) provat e dorëzuara nga subjekti i rivlerësimit në ILDKPKI në deklaratën e pasurisë për rivlerësimin kalimtar *Vetting*; (ii) raportin e dorëzuar në Komision nga ILDKPKI-ja; (iii) raportin mbi kontrollin e figurës, të dorëzuar në Komision nga DSIK-ja; (iv) provat shkresore/dokumentet e administruara nga organet publike dhe private, në përputhje me nenet 49 dhe 50 të ligjit nr. 84/2016; (v) raportin e përpiluar nga Këshilli i Lartë i Prokurorisë; (vi) deklaratimet dhe përgjigjet e subjektit të rivlerësimit të bëra me anë të komunikimit elektronik; (vii) shpjegimet me shkrim dhe dokumentacionin mbështetës, të paraqitura nga subjekti i rivlerësimit, pas njoftimeve të mbylljes së hetimeve administrative, së bashku me argumentimet e paraqitura në seancën dëgjimore; si dhe (viii) faktet e njohura botërisht.

A. VLERËSIMI I PASURISË

ILDKPKI-ja, bazuar në nenet 30 – 33 të ligjit nr. 84/2016, ka dërguar në Komision raportin lidhur me deklaratimet dhe vlerësimin e pasurisë së subjektit të rivlerësimit, znj. Ledina Lera, duke konstatuar se:

- *deklarimi nuk është i saktë në përputhje me ligjin;*
- *ka mungesë burimesh financiare të ligjshme për të justifikuar pasuritë;*
- *nuk ka kryer fshehje të pasurisë;*
- *nuk ka kryer deklaram të rremë;*
- *subjekti nuk gjendet në kushtet e konfliktit të interesave.*

Komisioni ka hetuar në mënyrë të pavarur mbi çdo informacion dhe konkluzion të institucionit të sipërpërmendur, ashtu sikurse mbi të gjitha faktet dhe informacionet e marra nga çdo subjekt i së drejtës, në përputhje me nenet 45, 49 dhe 50 të ligjit nr. 84/2016.

Hetimi administrativ në lidhje me vlerësimin e pasurisë ka konsistuar në: (i) verifikimin e vërtetësisë së deklaratimeve në lidhje me gjendjen pasurore të subjektit dhe personave të lidhur; (ii) verifikimin e burimeve të krijimit të të ardhurave dhe shpenzimeve, me qëllim evidentimin e mungesës së mundshme të burimeve të mjaftueshme financiare për të justifikuar pasuritë; (iii) evidentimin e ndonjë fshehjeje të mundshme të sendeve në pronësi ose përdorim; (iv) evidentimin e ekzistencës së mundshme të deklaratimeve të rreme apo të ndonjë konflikti të interesave, të parashikuar nga pika 5, e nenit 33, të ligjit nr. 84/2016.

A/1 RIVLERËSIMI I KRITERIT TË PASURISË

1. Apartament banimi me sipërfaqe 52 m², në Korçë

1. Kjo pasuri është deklaruar për herë të parë nga subjekti i rivlerësimit në deklaratën *Vetting*, ndërtim i para viteve '90 dhe i privatizuar me vlerën 16,370 lekë, me pjesë takuese 50%. Nga dokumentacioni i administruar ka rezultuar se apartamenti në fjalë është përfituar me kontratën e privatizimit, datë 15.7.1993, të nënshkruar ndërmjet N. K. B. Korçë dhe qiramarrësve E. R. dhe Ledina Riza, me vlerën 16,370 lekë.
2. Lidhur me arsyen e mosdeklarimit të kësaj pasurie në asnjë nga deklaratat periodike, subjekti i rivlerësimit ka shpjeguar, nëpërmjet përgjigjeve të pyetësorit nr. 2, se nuk e ka konsideruar asnjëherë këtë apartament si pasuri të saj, por si pasuri të prindërve, si dhe ka shpjeguar se mosdeklarimi formal në deklaratën fillestare të vitit 2003, ka qenë nga mungesa e përvojës, informacionit dhe moskonsiderimi si pronë e familjes së saj. Gjithashtu, nuk është deklaruar në deklaratat periodike të mëpasshme, pasi në to duhej të deklaroheshin vetëm shtesat/ndryshimet e pasurisë. Subjekti i rivlerësimit ka shtuar se nuk kishte asnjë arsye për të mos e deklaruar qëllimisht si pasuri, aq më tepër që në kohën e privatizimit ishte ende studente dhe pa të ardhura. Ndërsa, lidhur me burimin financiar për blerjen e apartamentit të sipërpërmendur¹, subjekti i rivlerësimit ka bërë me dije se vlera e privatizimit të banesës prej 16,370 lekësh, ka qenë përballuar nga nëna e saj dhe se ajo nuk ka pasur asnjë kontribut financiar, pasi ka qenë studente.
3. Lidhur me verifikimin e kësaj pasurie, Komisioni ka administruar dokumentacionin si vijon:
 - i. Me shkresat nr. *** prot., datë 5.11.2019 dhe nr. *** prot., datë 2.6.2020, ASHK-ja Korçë ka konfirmuar se subjekti i rivlerësimit, znj. Ledina Lera, figuron bashkëpronare në pasurinë e paluajtshme të llojit apartament me sip. 52 m², nr. pasurie ***, vol. ***, f. ***, z. k. ***.

¹ Ende pa certifikatën e pronësisë së apartamentit.

- ii. Kontratë për privatizimin e banesës (formulari nr. ***), datë 15.7.1993, e lidhur ndërmjet N. K. B. Korçë dhe qiramarrësve E. R. dhe Ledina Riza², me vlerën 16,370 lekë.
 - iii. Vërtetim nënshkrimi nr. ***, datë 14.10.1993, dhe vërtetim për regjistrimin e pasurisë, datë 16.10.1993.
 - iv. Me shkresën nr. *** prot., datë 27.7.2017, ZVRPP-ja Korçë ka konfirmuar se subjekti i rivlerësimit është bashkëpronare me 1/27 pjesë të kësaj pasurie dhe se mbi këtë pasuri është vendosur hipotekë në favor të NGB-së³.
4. Gjithashtu, lidhur me sa më sipër, subjekti i rivlerësimit ka vënë në dispozicion të Komisionit, së bashku me përgjigjet e pyetësorit nr. 2, vërtetimin nr. *** prot., datë 19.5.2020, të lëshuar nga “ABI Bank”, nëpërmjet të cilit konfirmohet se pasuria e sipërcituar nuk rezulton të jetë kolateral për këtë bankë, si dhe nuk rezulton të ketë qenë kolateral për ish-NGB. Gjithashtu, në përgjigje të pyetësorit nr. 2, subjekti i rivlerësimit ka bashkëngjitur edhe një vërtetim të ASHK-së Korçë, nga ku konfirmohet pjesa takuese e subjektit, prej 1/2 mbi këtë pasuri, si dhe fakti që mbi këtë pasuri nuk rëndon asnjë barrë apo hipotekë⁴.

Vlerësimi i trupit gjykues

5. Në vijim të analizimit të përmbajtjes së dokumentacionit të administruar, si dhe të shpjegimeve të paraqitura nga subjekti, trupi gjykues vlerëson se ndonëse mbetet mosdeklarimi i pjesës takuese në vitin 2003, nisur nga koha e blerjes, inekzistenca e certifikatës së pronësisë, rrethanat e tjera, si dhe vlera minimale e pasurisë, pasaktësia e konstatuar, në mungesë të problematikave të tjera për këtë pasuri, nuk mund të përbëjë shkak penalizues për subjektin e rivlerësimit.

2. Apartament banimi me sipërfaqe 130 m², “Rr. E.”, Tiranë

6. Kjo pasuri është deklaruar për herë të parë në DIPP-në e vitit 2003 – me burim krijimi nga kredia e marrë pranë ish-Bankës së Kursimeve në vlerën 4,000,000 lekë dhe kontribute nga të ardhurat familjare. Ndërsa në deklaratën *Vetting* është deklaruar me vlerë 40,000 USD⁵ – me burim krijimi nga kredia e butë e marrë në ish-Bankën e Kursimeve, në vlerën 4,000,000 lekë dhe diferenca nga kursimet familjare. Apartamenti në fjalë është përfituar nëpërmjet kontratës së shitblerjes nr. ***, datë 29.12.2000, të lidhur ndërmjet blerësve N. L. dhe Ledina Lera (Riza) dhe palës shitëse shoqërisë ndërtuese “F. C.” sh.p.k., kundrejt çmimit total prej 40,000 USD.
7. Nga hetimi administrativ ka rezultuar se përpara kësaj kontrate ishte nënshkruar kontrata e sipërmarrjes nr. ***, datë 28.2.2000, me objekt ndërtimin dhe shitjen e apartamentit në godinën që po ndërtohej në “Rruga E.”, me sipërfaqe ndërtimi 110 m². Në nenin V, të kësaj kontrate ishte përcaktuar se pagesa e vlerës së apartamentit do të likuidohej përkatësisht në vlerën 4,000,000 lekë nga kredia në ish-Bankën e Kursimeve, sipas shkallës së punimeve të kryera dhe se diferenca është likuiduar nga pala porositore me pagesë të menjëhershme në momentin e lidhjes së kontratës.
8. Lidhur me mospërputhjen e sipërfaqes së apartamentit të banimit që rezulton midis kontratës së sipërmarrjes dhe kontratës së shitblerjes, nëpërmjet përgjigjeve të pyetësorit

² Mbiemri i vajzërisë së subjektit të rivlerësimit.

³ Nga shkresa nr. *** prot., datë 23.10.2019, nga “ABI Bank” (ish-NGB) nuk rezultoi që subjekti i rivlerësimit, bashkëshorti apo nëna e saj të jenë apo të kenë qenë klientë pranë kësaj banke.

⁴ Çka tregon se kemi të bëjmë me një lapsus nga ZVRPP-ja Korçë në shkresën e vitit 2017.

⁵ Shuma 40,000 USD është konvertuar në kontratën e sipërmarrjes së datës 28.2.2000, të lidhur me shoqërinë ndërtuese “F. C.” sh.p.k., në vlerën 5,600,000 lekë.

nr. 2, subjekti i rivlerësimit ka shpjeguar se bëhet fjalë për të njëjtin apartament dhe se nuk kanë nënshkruar asnjë kontratë për ndonjë apartament tjetër apo shtesë/modifikim të kontratës së sipërmarrjes, lidhur me sipërfaqen e apartamentit në fjalë. Gjithashtu, subjekti ka pohuar se mospërputhja mund të ketë qenë gabim i përshkrimit në kontratat paraprake nga stafi i shoqërisë që ishte i ngarkuar me hartimin dhe se pas nënshkrimit të kontratës së sipërmarrjes të vetmet modifikime që janë bërë nga projekti fillestar ishin rikonfigurime të disa ambienteve të brendshme, të përbashkëta, të cilat u bënë nga shoqëria ndërtuese brenda çmimit të kontratës.

9. Subjekti i rivlerësimit, së bashku me përgjigjet e pyetësorit nr. 2, ka paraqitur edhe deklaratën noteriale nr. ***, datë 1105.2020, të lëshuar nga shoqëria “F. C.” sh.p.k., përfaqësuar nga administratori R. F., i cili ka deklaruar se apartamenti me nr. hipotekor ***, me sip. 130 m² është i njëjti apartament i prenotuar nga blerësit me kontratën e sipërmarrjes, datë 28.2.2000 dhe kontratën e shitblerjes, datë 29.12.2000. Gjithashtu, ka deklaruar se shoqëria ka lidhur me blerësit N. L. dhe Ledina Lera vetëm këto dy kontrata dhe nuk ka asnjë kontratë tjetër midis palëve.
10. Gjithashtu, ka rezultuar se ish-Banka e Kursimeve (sot “Raiffeisen Bank”), me kontratën e kredisë⁶ nr. ***, datë 19.4.2000, i ka akorduar subjektit të rivlerësimit, znj. Ledina Lera, kredi në shumën 4,000,000 lekë, me objekt *ndërtim banesë*. Në praktikën e kredisë për strehim bashkëngjitur ndodhet edhe një kërkesë personale nga subjekti i rivlerësimit, datë 31.1.2000, me objekt kreditimin nga ish-Banka e Kursimeve në përputhje me VKM-në nr. 102, datë 5.3.1999, “Për trajtimin me strehim të funksionarëve politikë dhe nëpunësve civilë të administratës së lartë shtetërore”, në të cilën ka deklaruar se familjarisht dhe personalisht nuk zotëron banesë të përfutur nga procesi i privatizimit të banesave nga Enti Kombëtar i Banesave apo të fituar në çdo mënyrë tjetër ligjore⁷.
11. Nga analizimi i dokumentacionit të vënë në dispozicion nga institucioni kredidhënës, ka rezultuar se marrja e kredisë nga subjekti i rivlerësimit është bërë në kuadër të trajtimit me kredi si e pastrehë, në përputhje me dispozitat e nenit 12, të ligjit nr. 8095, datë 21.3.1996, “Për shërbimin civil në Republikën e Shqipërisë”, në zbatim të pikës 2, të Vendimit të Këshillit të Ministrave nr. 810, datë 28.12.1998, “Për dhënien e fondeve buxhetore për skemën e trajtimit me strehim të funksionarëve politikë dhe nëpunësve civilë të administratës së lartë shtetërore”, si dhe në zbatim të Vendimit të Këshillit të Ministrave nr. 102, datë 5.3.1999, “Për trajtimin me strehim të funksionarëve politikë dhe nëpunësve civilë të administratës së lartë shtetërore”. Ndër të tjera, në vendimin e sipërcituar përcaktohet se: *“Për sa kohë funksionarët e lartë, nëpunësit civil, Prokurori i Përgjithshëm dhe çdo nivel i barazuar me ta, ushtrojnë funksionet e tyre dhe janë pa banesë ose kanë nevojë për një shtesë sipërfaqe banimi, u lind e drejta të kërkojnë strehim nga shteti”*.
12. Lidhur me këtë deklaram, në kërkesën personale të sipërcituar, subjekti i rivlerësimit ka sqaruar nëpërmjet përgjigjeve të pyetësorit nr. 2 se: *“[...] Në korrik të vitit 1997, jam sulmuar në shtëpi nga kriminele të armatosur, ku si rezultat i goditjeve të shtëpisë është plagosur rëndë vjehëri im dhe kam pësuar dëmtime edhe unë. Si rezultat i situatës së*

⁶ Për garantimin e kontratës së kredisë është nënshkruar kontrata e dorëzimit nr. ***, datë 19.4.2000, midis dorëzimit H. F., huamarrësit Ledina Lera dhe huadhënësit ish-Banka e Kursimeve, për hipotekimin e pasurisë së paluajshme të pasurisë nr. ***, z. k. ***, Tiranë, me sip. 98.20 m² dhe deklarata noteriale nr. ***, datës 28.2.2000, e dorëzimit H. F., në dobi të huadhënësit si garanci për përmbushjen e detyrimeve nga huamarrësi.

⁷ Ndërkohë që pasuria apartament me sip. 52 m², ndodhur në Korçë, trajtuar në pikën 1, është përfutur në vitin 1993 nëpërmjet privatizimit nga nëna dhe subjekti i rivlerësimit dhe kjo e fundit zotëronte 50% të pasurisë në momentin e deklaramit. Referuar VKM-së nr. 102, datë 5.3.1999, pika 2 përcaktonte: *“Gjatë kohës që funksionarët politikë dhe nëpunësit civilë të administratës së lartë shtetërore të përmendur më sipër janë në këto funksione dhe janë pa banesë ose kanë nevojë për një shtesë sipërfaqe banimi, u lind e drejta të kërkojnë strehim ng shteti”*.

krijuar në Korçë, u transferova e komanduar në Prokurorinë e Përgjithshme. Tre vitet e para të transferimit në Tiranë kam jetuar me qira⁸ në një apartament në shtëpinë e shtetas A. M.. Për shkak të mungesës së kushteve të përshtatshme për jetesë, Prokurori i Përgjithshëm e pa të arsyeshme që në listën e propozuar të prokuroreve që do të përfitonin kredi strehimi, të isha edhe unë, propozim ky që u miratua edhe nga organet ekzekutive të shtetit. Më pas jam paraqitur në Bankën e Kursimeve për të plotësuar formalisht formularët e kërkuar dhe dokumentacionin tjetër të kredisë. VKM-ja nr. 102, datë 5.3.1999, në pikën , përcaktonte dokumentet që dorëzon përfituesi i kredisë”.

13. Nga hetimi administrativ ka rezultuar se përpara kësaj kontrate ishte nënshkruar kontrata e sipërmarrjes nr. ***, datë 28.2.2000, me objekt ndërtimin dhe shitjen e apartamentit në godinën që po ndërtohej në “Rr. E.”, me sipërfaqe ndërtimi 110 m². Në nenin V, të kësaj kontrate ishte përcaktuar se pagesa e vlerës së apartamentit do të likuidohej 4,000,000 lekë nga kredia në ish-Bankën e Kursimeve, sipas shkallës së punimeve të kryera dhe se diferenca është likuiduar nga pala porositëse me pagesë të menjëhershme në momentin e lidhjes së kontratës. Nga sa më sipër, duket se kredia për strehim marrë nga subjekti i rivlerësimit është vlerësuar dhe aprovuar nga institucionet përkatëse, në zbatim të Vendimit të Këshillit të Ministrave nr. 102, datë 5.3.1999.
14. Me urdhërxhirimin e jashtëm nr. ***, datë 20.4.2000, nga Banka e Kursimeve subjekti i rivlerësimit ka transferuar shumën prej 3,800,000 lekësh, si dhe me urdhërxhirimin e jashtëm nr. ***, datë 25.4.2001, shumën prej 200,000 lekësh, në favor të shoqërisë ndërtuese “F. C.” sh.p.k., që në total përbëjnë shumën e kredisë prej 4,000,000 lekësh, me përshkrimet përkatëse “likuiduar sipas situacioneve të punimeve⁹ dhe VKM-së nr. 102, datë 5.3.1999”.
15. Në përgjigje të pyetësorit nr. 2, subjekti i rivlerësimit ka vendosur në dispozicion edhe mandatpagesat e kryera nga bashkëshorti në arkën e shoqërisë ndërtuese “F. C.” sh.p.k., konkretisht:
 - a. në datën 5.2.2000, shumat 2,000 USD dhe 300,000 lekë;
 - b. në datën 10.02.2000, shumën 600,000 lekë; dhe
 - c. në datën 28.2.2000, shumën 4,000 USD.
16. Pagesat në total arrijnë në vlerën 1,776,464 lekë¹⁰ dhe së bashku me kredinë prej 4,000,000 lekësh përbëjnë çmimin e plotë 40,000 USD, të apartamentit në analizë, të cilat janë konfirmuar edhe nga shoqëria “F. C.” sh.p.k., me anë të një vërtetimi (pa datë) të nënshkruar nga z. H. F., ku është konfirmuar se me transferimin e shumës prej 4,000,000 lekësh nga kredia, porositësi N. L. ka shlyer apartamentin e porositur sipas kontratës së sipërmarrjes, datë 28.2.2000, si dhe kontratës së shitblerjes, datë 29.12.2000.
17. Në DIPP-në e vitit 2003¹¹ subjekti i rivlerësimit ka deklaruar si burim për pagesën e kësaj diference prej 1,776,464 lekësh të çmimit të apartamentit, kontributet nga të ardhurat familjare dhe në deklaratën *Vetting* të ardhurat nga kursimet familjare. Subjekti i

⁸ Subjekti i rivlerësimit ka deklaruar se pas transferimit në janar të vitit 1998 në Tiranë dhe më pas emërimit si prokurore në Prokurorinë e Përgjithshme, ka jetuar me qira për një periudhë 3-vjeçare, kundrejt pagesës 10,000 lekë/muaj. Referuar përgjigjeve të subjektit të rivlerësimit, ka deklaruar se qiradhënësja A. M. ka ndërruar jetë. Apartamenti i banimit ka qenë në zonën mbi maternitetin e ri.

⁹ Referuar situacioneve të punimeve 1 dhe 2, sipërfaqja e ndërtimit është 110 m² dhe vlera e ndërtimit është 5,607,039 lekë.

¹⁰ Vlerat e paguara në dollar janë konvertuar me kursin mesatar të fundit të vitit 2000, ku 1 USD këmbehej me 146.077 lekë.

¹¹ Në DIPP-në e vitit 2003 gjenden dy formularë A-1. Në njërin, në kolonën “vlefte në milionë lekë” është shënuar shuma 40,000 USD, firmosur nga subjekti i rivlerësimit datë 1.12.2006 me shkrim dore, ndërsa në tjetrën shifra prej 4 (milionë) lekësh.

rivlerësimit ka deklaruar në rubrikën përkatëse të detyrimeve, duke filluar nga DIPP-ja e vitit 2003 dhe në vijim, shlyerjen e kredisë pranë Bankës së Kursimeve dhe më pas në “Raiffeisen Bank”.

18. Përgjatë hetimit administrativ për këtë pasuri, Komisioni ka administruar dokumentacionin si vijon:
- i. ASHK-ja Tiranë, me shkresën nr. *** prot., datë 14.11.2019, ka konfirmuar pasurinë e paluajtshme apartament me nr. ***, vol. ***, f. ***, z. k. ***, me sip. 130 m², në emër të shtetasve Ledina Lera dhe N. L..
 - ii. Kontratë sipërmarrje nr. ***, datë 28.2.2000, për ndërtimin dhe shitjen e apartamentit në katin e shtatë me sip. 110 m² me çmim 40,000 USD ose 5,600,000 lekë, nënshkruar midis palës sipërmarrëse shoqërisë ndërtuese “F. C.” sh.p.k dhe porositësve Ledina dhe N. Lera.
 - iii. Mandatpagesat në arkën e shoqërisë shitëse “F. C.” sh.p.k., për pagesën e këstit të parë, përkatësisht: mandatpagesa, datë 5.2.2000, për shumat 2,000 USD dhe 300,000 lekë; mandatpagesa, datë 10.2.2000, për shumën 600,000 lekë; dhe mandatpagesa, datë 28.2.2000, për shumën 4,000 USD.
 - iv. Deklaratë noteriale nr. ***, datë 28.2.2000, e administratorit H. F. të shoqërisë ndërtuese, i cili ka vendosur si garanci hipotekore¹² apartamentin me sip. 98 m² në favor të Bankës së Kursimeve për të garantuar kredinë e marrë deri në momentin e regjistrimit të pronës së re në hipotekë nga znj. Ledina Lera¹³.
 - v. Kontratë kredie nr. ***, datë 19.4.2000, me objekt *ndërtim banese*. Për garantimin e kontratës së kredisë është nënshkruar kontrata e dorëzarisë nr. ***, datë 19.4.2000, midis dorëzansit H. F., huamarrësit Ledina Lera dhe huadhënësit ish-Banka e Kursimeve, për hipotekimin e pasurisë së paluajtshme me sip. 98.20 m², nr. ***, z. k. ***, Tiranë.
 - vi. Kontratë shitblerje nr. ***, datë 29.12.2000, ndërmjet palës shitëse shoqërisë ndërtuese “F. C.” sh.p.k. dhe palës blerëse N. L. dhe Ledina Riza (Lera), për blerjen e apartamentit në katin e shtatë me sip. 130 m², me vlerë 40,000 USD, shumë e cila deklarohet se është paguar plotësisht prej blerësit¹⁴ jashtë zyrës noteriale.
 - vii. Vërtetim hipotekor për pasurinë me sip. 130 m², nr. ***, z. k. ***, në emër të subjektit të rivlerësimit dhe bashkëshortit të lëshuar në datën 20.3.2001.
 - viii. Kërkesë, datë 20.4.2001, ku subjekti i rivlerësimit i drejtohet Bankës së Kursimeve për zëvendësimin/ndryshimin e kolateralit të vendosur si garanci hipotekore nga apartamenti me sip. 98 m², të ofruar nga shoqëria “F. C.” sh.p.k., për garantimin përkohësisht të kredisë, duke vendosur si kolateral apartamentin objekt kreditimi me sip. 130 m², në pronësi të subjektit të rivlerësimit dhe bashkëshortit.
 - ix. Kontratë hipotekimi nr. ***, datë 14.6.2001, ku hipotekuesit N. L. dhe Ledina Lera kanë hipotekuar në favor të Bankës së Kursimeve Tiranë, pasurinë e paluajtshme të llojit

¹² Vërtetim nga dokumentet hipotekore në emër të shoqërisë “F. C.” sh.p.k., dhe familjes K., pasuri e regjistruar në hipotekë me nr. *** regj., datë 24.2.1998, z. k. ***, leje ndërtimi, kontratë shkëmbimi midis tyre, vendim nr. ***, datë 14.10.1996, i KRRT-së Bashkia Tiranë, gent-plan dhe planimetri.

¹³ Në deklaratën noteriale shprehet se pas marrjes së lejes së shfrytëzimit, Banka e Kursimeve do të kryejë zhblokimin e pronës së sipërpërmendur, duke bllokuar pronën e subjektit të rivlerësimit deri në shlyerjen e plotë të kredisë së marrë.

¹⁴ Sipas urdhërshirimit shuma prej 200,000 lekësh, e cila përbënte edhe situacionin përfundimtar, është paguar në datën 25.4.2001. Vërtetimi hipotekor për regjistrimin e pasurisë në emër të subjektit të rivlerësimit është lëshuar në datën 20.3.2001, pra, rreth 1 muaj përpara pagesës së fundit. Me kontratën e hipotekimit nr. ***, datë 14.6.2001, është hipotekuar apartamenti objekt kreditimi me sip. 130 m², në favor të Bankës së Kursimeve.

apartament me sip. 130 m², z. k. ***, ndodhur në “Rr. E.”, për sigurimin e kredisë së lëvruar prej 4,000,000 lekësh, gjithashtu, për këtë pasuri është kryer bllokimi sipas vërtetimit, datë 18.6.2001.

2.1 Lidhur me analizimin e burimeve të krijimit të kësaj pasurie

19. Në DIPP-në e vitit 2003 dhe në deklaratën *Vetting*, subjekti i rivlerësimit ka deklaruar si burim të krijimit të kësaj pasurie, kredinë e butë të marrë pranë ish-Bankës së Kursimeve dhe kontributet nga kursimet familjare. Ish-Banka e Kursimeve me kontratën e huas nr. ***, datë 19.4.2000, me objekt *ndërtim banesë* i ka akorduar huamarrësit Ledina Lera shumën prej 4,000,000 lekësh me afat 25 vjet, me kushtin që lëvrimi i huas do të bëhej me pjesë sipas situacioneve që do të paraqiteshin nga huamarrësi. Me urdhërxhirimin e jashtëm është paguar shuma 3,800,000 lekë, datë 20.4.2000, nga subjekti i rivlerësimit në favor të shoqërisë ndërtuese “F. C.” sh.p.k. dhe shuma 200,000 lekë është shlyer në datën 25.4.2001.
20. Shuma e mbetur e kredisë prej 200,000 lekësh është transferuar në favor të shoqërisë “F. C.” sh.p.k., në datën 25.4.2001, ndërkohë që referuar kontratës së shitblerjes, datë 29.12.2000, shuma prej 40,000 USD, ishte paguar plotësisht prej blerësve. Subjekti i rivlerësimit ka sqaruar nëpërmjet pyetësorit nr. 2, se: *“Banka ka pasur rregullat e saj të disbursimit të kredisë. Shuma e kredisë akorduar ka qenë 4,000,000 lekë dhe me paraqitjen e dokumentacionit fillestar të vendosjes së hipotekës dhe nënshkrimit të kontratës, disbursoi 95% të kredisë dhe diferenca do të disbursohej pasi të paraqitej kontrata e shitjes dhe të bëhej hipoteka. Ishte rregull i njohur në atë kohë dhe firma e ndërtimit ishte e sigurt që banka do t’i kalonte diferencën prej 5%.”*
21. Lidhur me burimin e të ardhurave për likuidimin e këstit të parë të çmimit të blerjes së apartamentit, subjekti i rivlerësimit ka specifikuar në përgjigje të pyetësorit nr. 2, se janë përdorur të ardhurat familjare (të saj dhe të bashkëshortit) të periudhës 1996 – shkurt 2000; të ardhura në shumën 1,500 USD të bashkëshortit nga investimi në ish-firmën piramidale “V.”, të tërhequra në qershor të vitit 1997; të ardhura në masën 200,000 lekë nga kursimet e bashkëshortit dhe familjes së tij (dhënë bashkëshortit përpara martesës)¹⁵; si dhe kursime të subjektit të rivlerësimit përpara martesë në shumën 50,000 lekë. Së bashku me përgjigjet e pyetësorit nr. 2, subjekti i rivlerësimit ka vendosur në dispozicion të Komisionit dy mandatpagesa të kryera nga bashkëshorti pranë ish-firmës piramidale “V.”, Korçë, përkatësisht dy mandatpagesa depozitimi në shumën 1,500 USD, datë 25.9.1996, si dhe në shumën 1,500 USD, datë 24.6.1997. Nga ky dokumentacion i paraqitur nuk konfirmohen të gjitha transaksionet e kryera nga bashkëshorti i subjektit të rivlerësimit dhe, për rrjedhojë, këto të ardhura në shumën 1,500 USD, nuk janë marrë në konsideratë në analizën financiare.
22. Në vijim të administrimit dhe të shqyrtimit të dokumentacionit të nevojshëm për analizimin e burimeve financiare të krijimit të kësaj pasurie, Komisioni ka kryer analizën financiare për të identifikuar mundësinë e kursimit të familjes së subjektit të rivlerësimit. Në këtë analizë janë marrë në konsideratë të ardhurat¹⁶ nga punësimi i subjektit të rivlerësimit dhe

¹⁵ Subjekti i rivlerësimit ka sqaruar se kjo shumë prej 200,000 lekësh nuk ka qenë dhuratë nga prindërit, por pjesë e kontributit të tij në familje përpara martesës. Prindërit e bashkëshortit në atë periudhë ishin pensionistë, por kishin dhe burime të tjera suplementare nga depozita kursimi në Bankën e Kursimeve dhe të ardhura nga qiraja e shtëpisë në Korçë, prej 30,000 lekë/muaj sipas kontratës nr. ***, datë 19.2.1998.

¹⁶ Vërtetim nr. *** prot., datë 20.10.2016. nga Prokuroria pranë Gjykatës së Rrethit Gjyqësor Korçë për subjektin Ledina Lera për periudhën nëntor 1993 – janar 1999; vërtetim nr. *** prot., datë 25.10.2016. nga Prokuroria e Përgjithshme për subjektin Ledina Riza për periudhën 16 janar 1999 – 31 janar 2008; vërtetim nga ISSH-ja Korçë për shtetasin N. L. për periudhën tetor 1992 – tetor 1997; vërtetim nr. *** prot., datë 18.10.2016. nga Drejtoria e përgjithshme e tatimeve për shtetasin N. L. për periudhën 1997 – 2009.

bashkëshortit, të cilat kanë rezultuar në masën 2,989,642 lekë, si dhe shpenzimet¹⁷ për periudhën 1996 – janar 2000 (duke qenë se sipas kontratës së porosisë dhe mandatpagesave të paraqitura, shlyerja e diferencës së çmimit të apartamentit është kryer nga pala porositëse në shkurt të vitit 2000), në masën 1,123,016 lekë. Për sa i përket dy burimeve të tjera të përmendura nga subjekti, kursimet e saj dhe të bashkëshortit përpara martesë, mbeten në nivel deklarativ, si dhe nuk ndikojnë në rezultatin final për mundësinë e blerjes së kësaj pasurie. Në mënyrë të përmbledhur është paraqitur analiza financiare për periudhën janar 1996 – janar 2000, për të përcaktuar mundësinë për pagesën e kështit të parë, gjatë muajit shkurt të vitit 2000.

Tabela nr. 1 - Përlllogaritja e burimeve të përdorura për blerjen e apartamentit

Te ardhurat e vitit 96-janar 2000	2,989,642
Blerja e apartamentit ne Tirane	(5,776,464)
Kredi pranë Bankes se Kursimeve	4,000,000
Shpenzime jetese 96-janar 2000	(662,584)
Shpenzime qiraje	(240,000)
Rezultati	310,594

Qëndrimi i subjektit të rivlerësimit

23. Pasi është njohur me rezultatet e hetimit administrativ, subjekti i rivlerësimit, lidhur me këtë pasuri, veç të tjerash, është shprehur se: [...]“*Kjo diferencë është si rezultat i mospasqyrimit të sipërfaqeve të përbashkëta në kontratën paraprake, e cila është lidhur në kohën kur ndërtesa ka qenë në karabina dhe nuk mund të bëhej përcaktimi me saktësi i pjesës takuese të sipërfaqeve të përbashkëta. Në momentin e përpilimit të kontratës përfundimtare, pasi ndërtimi kishte përfunduar komplet, firma ishte në gjendje të përcaktonte me saktësi sipërfaqen totale (brenda apartamentit dhe sipërfaqen e përbashkët), e cila rezultoi 130 m²” [...].*
24. Gjithashtu, subjekti i rivlerësimit ka paraqitur në cilësinë e provës deklaratën noteriale nr. ***, datë 19.2.2021, të lëshuar nga shoqëria “F. C.” sh.p.k., nëpërmjet të cilës ka pohuar se diferenca prej 20 m² vjen si rezultat i mospasqyrimit në kontratën e sipërmarrjes të sipërfaqeve të përbashkëta.

Vlerësimi i trupit gjykues

25. Nisur nga sa më sipër, trupi gjykues vlerëson se nuk janë konstatuar problematika lidhur me burimet e ligjshme financiare për blerjen e pasurisë në fjalë. Lidhur me mospërputhjen e sipërfaqeve të përshkruara në kontratat respektive (të sipërmarrjes dhe të blerjes), çmohet se ajo nuk mund të përbëjë shkak penalizues për subjektin, jo vetëm sepse deklarimi është bërë në raport me përmbajtjen kontraktore respektive, por edhe për faktin se duke mbajtur në vëmendje edhe shpjegimet e subjektit dhe deklarimin e shoqërisë ndërtuese, ato duken bindëse dhe nuk rezultojnë në dëm të subjektit të ndonjë shtese të sipërfaqes ndërtimore pa kundërshtim, por kjo ka ndodhur (si në shumë raste të tjera), për shkak të përfshirjes së pjesëve të përbashkëta vetëm në një moment të dytë – pas nënshkrimit të kontratës së sipërmarrjes – në certifikatën e vërtetimit të pronësisë, rrjedhimisht edhe në kontratën e shitjes. Për rrjedhojë, nuk konstatohen problematika lidhur me këtë pasuri që mund të evidentojnë ndonjë përgjegjësi të subjektit të rivlerësimit.

¹⁷ Shpenzimet jetike janë përlllogaritur për 2 persona, në masën 66% të të ardhurave për vitin 1996 (bazuar në jurisprudencën e KPA), me 5,000 lekë/muaj për person për periudhën 1997 – 1999 dhe sipas të dhënave të INSTAT-it për muajin janar të vitit 2000. Gjithashtu, janë përlllogaritur shpenzimet e qirasë për periudhën janar 1998 – janar 2000, në masën 10,000 lekë/muaj, sipas deklarimit të subjektit të rivlerësimit në përgjigje të pyetësorit.

3. Tokë me sipërfaqe 345 m², në V., Korçë

26. Kjo pasuri rezulton të jetë deklaruar nga bashkëshorti i subjektit të rivlerësimit në DIPP-në e vitit 2003, në vlerën 276,000 lekë, me burim të ardhurat familjare dhe është deklaruar nga subjekti i rivlerësimit për herë të parë në deklaratën *Vetting*. Bëhet fjalë për një sipërfaqe 345 m² toke e llojit “arë”, përfituar me kontratën e pjesëtimit vullnetar nr. ***, datë 8.11.2003, në të cilën pronarët N. K., Th. T., N. L.¹⁸ dhe E. K., kanë rënë dakord për ndarjen e pasurisë me sip. 1,380 m², në 4 pjesë të barabarta me nga 345 m² secili. Sipërfaqja e tokës prej 1,380 m² ishte blerë më parë prej tyre me kontratën e shitblerjes nr. ***, datë 9.7.2003, kundrejt çmimit 400,000 lekë.
27. Në përgjigje të pyetësorit nr. 2, lidhur me arsyen e mosdeklarimit të kësaj pasurie prej subjektit të rivlerësimit në deklaratat periodike, kjo e fundit, është shprehur se pasuria ishte deklaruar nga bashkëshorti në DIPP-në e vitit 2003 (duke qenë se në këtë periudhë ishte subjekt deklarimi. Gjithashtu subjekti ka sqaruar se në deklaratat periodike të mëpasshme nuk kishte kuptim deklarimi i kësaj pasurie, pasi ato kërkonin pasurinë e krijuar brenda atij viti dhe jo deklaratat të pasurisë kumulative dhe se deklarimi është bërë sipas kërkesave në deklaratën *Vetting*.
28. Lidhur me faktin që pasuria figuron e regjistruar në emër të N. L. dhe jo N. L., subjekti i rivlerësimit ka sqaruar se bashkëshorti nuk ka pasur asnjëherë ndryshim të emrit, por kjo situatë ka ardhur nga shkurtimi i emrit në N. në jetën e përditshme. Subjekti i rivlerësimit i ka bashkëlidhur pyetësorit nr. 2, disa dokumente¹⁹ në të cilat janë përdorur emrat N. L. dhe N. L.. Gjithashtu, nëpërmjet pyetësorit nr. 2, Komisioni i ka kërkuar subjektit të bëjë me dije nëse mbi këtë pasuri është kryer ndonjë ndërtim/investim. Subjekti i rivlerësimit ka shpjeguar se mbi këtë pasuri edhe në momentin e blerjes edhe aktualisht nuk ka kryer ndonjë investim/ndërtim dhe për të provuar sa më sipër deklaruar, së bashku me përgjigjet e pyetësorit, ka bashkëlidhur edhe foto të gjendjes aktuale të pasurisë.
29. Lidhur me verifikimin e kësaj pasurie Komisioni ka administruar dokumentacionin si vijon:
- i. Me shkresën nr. *** prot., datë 25.9.2017, të ZQRPP-së Korçë dhe me shkresën nr. *** prot., datë 2.6.2020, ASHK-së Korçë ka konfirmuar se në emër të shtetasit N. (N.) L. figuron e regjistruar pasuria e llojit arë me sip. 345 m², si dhe ka bashkëngjitur praktikën²⁰.
 - ii. ALUIZNI²¹ me shkresën nr. *** prot., datë 20.7.2017, ka konfirmuar se subjekti i rivlerësimit dhe personat e lidhur nuk figurojnë aplikues për vetëdeklarimin e ndonjë objekti informal, në funksion të përfshirjes në procesin e legalizimeve.
 - iii. Kontratë shitblerje nr. ***, datë 9.7.2003, lidhur midis palës shitëse P. B., P. B., M. B. dhe M. B. dhe blerësve N. K., Th. T., N. L. dhe E. K., për blerjen e pasurisë me nr. ***, vol. ***, f. ***, z. k. ***, me sip. 1,380 m², kundrejt çmimit 400,000 lekë.

¹⁸ Z. N. L. në këtë kontratë është përfaqësuar me prokurë të posaçme, datë 9.7.2003, nga z. Th. T..

¹⁹ Subjekti i rivlerësimit ka bashkëngjitur diplomën e Fakultetit të Ekonomisë të bashkëshortit, ku figuron me emrin N. L.; diplomë *Master* në Fakultetin e Ekonomisë me emrin N. L.; vendimin nr. ***, datë 4.2.1998, për emërimin e z. N. L. në detyrën e Drejtorit të Drejtorisë së Administrimit të Tatimeve dhe emërimin e z. N. L. në datën 16.5.2003 si Drejtor në Drejtorinë Operacionale të Degëve të Tatimeve.

²⁰ Bashkëlidhur certifikatës së pronësisë dhe kartelës së pasurisë nr. ***, në z. k. ***, f. ***, vol. ***, me sip. 1,380 m², në emër të shtetasve N. K., Th. T., N. L. dhe E. K.; kontratë shitblerje dhe kartela e pasurisë nr. ***, me sip. 345 m², në emër të z. N. L..

²¹ Agjencia e Legalizimit, Urbanizimit dhe Integritimit të Zonave/Ndërtimeve Informale.

- iv. Kontratë pjesëtimi vullnetar nr. ***, datë 8.11.2003, midis bashkëpronarëve N. K., Th. T., N. L. dhe E. K., të cilët kanë rënë dakord për pjesëtimin e pasurisë, nga pjesëtimi i të cilës bashkëshorti i subjektit të rivlerësimit ka përfituar sip. 345 m².
- v. Certifikatë pronësie e pasurisë së llojit “arë” me sip. 345 m², nr. pasurie ***, vol. ***, f. ***, z. k. ***, reregjistruar në emër të shtetasit N. S. L..

3.1 Lidhur me analizimin e burimeve të krijimit të kësaj pasurie

30. Burimi i krijimit të kësaj pasurie është deklaruar në deklaratën *Vetting* nga të ardhurat familjare. Komisioni ka kryer analizën financiare për të identifikuar mundësinë e kursimit të familjes së subjektit të rivlerësimit, që kanë shërbyer më pas për blerjen e kësaj pasurie në datën 9.7.2003. Për këtë arsye, në analizë janë marrë në konsideratë të ardhurat²² nga punësimi i subjektit të rivlerësimit dhe bashkëshortit, të cilat kanë rezultuar në masën 1,421,030 lekë dhe shpenzimet²³ në masën 530,606 lekë, për periudhën janar – qershor 2003. Në mënyrë të përmbledhur, në tabelën që vijon, është paraqitur analiza financiare për 6-mujorin e parë të vitit 2003, për të përcaktuar mundësinë e blerjes së tokës arë në V., Korçë.

Tabela nr. 2 - Përlllogaritja e burimeve të përdorura për blerjen e kësaj pasurie

Te ardhurat janar - qershor 2003	1 421 030
Blerja e tokes ne Voskopoje	(276 000)
Shpenzime janar - qershor 2003 (jetese+kredi)	(254 606)
Rezultati (09.07.2003)	890 424

Gjithashtu, përgjatë hetimit administrativ, Komisioni ka konstatuar se bashkëshorti i subjektit të rivlerësimit, ndonëse ka investuar në këtë pasuri shumë prej 276,000 lekësh, e cila përbën rreth 69% të investimit total prej 400,000 lekësh të blerjes së pasurisë, ka përfituar të drejtat reale për 25%, pra, në një kuotë më të vogël në raport me investimin.

31. Lidhur me këtë investim, bashkëshorti i subjektit të rivlerësimit ka sqaruar në përgjigje të pyetësorit nr. 2, se me bashkëpronarët e tjerë ka dhe ka pasur marrëdhënie njohjeje të hershme. Gjithashtu, ka sqaruar se me blerjen e kësaj pasurie nuk është marrë personalisht, por ka qenë shtetasi N. K. person i autorizuar për kryerjen e veprimeve dhe se këtij të fundit i ka paguar shumë prej 276,000 lekësh, sipas çmimit të propozuar prej tij, 800 lekë /m².

Vlerësimi i trupit gjykues

32. Në konkluzion të analizimit të kësaj pasurie, përpos moskonstatimit të problematikave lidhur me burimin financiar që ka mundësuar blerjen e saj, trupi gjykues – duke konsideruar: (i) faktin që veprimet janë vetëm në emër të bashkëshortit të subjektit dhe të kryera nga një person i tretë; (ii) kohën dhe mënyrën e tjetërsimit, si dhe vlerën e diferencës lidhur me blerjen e pjesës takuese; (iii) faktin që as bashkëshorti i subjektit dhe as subjekti, nëpërmjet këtij veprimi juridik, nuk kanë përfituar pasuri më shumë se sa kanë paguar, përkundrazi, raporti i zhdrejtë shkon në disfavor të tyre; (iv) për rrjedhojë, nuk ka pasur ndonjë trajtim preferencial apo ndonjë përfitim të dyshimtë; (v) që dinamika e marrëdhënies juridiko-civile mund të jetë influencuar nga ekzistenca e njohjes dhe e

²² Vërtetim nr. *** prot., datë 25.10.2016, nga Prokuroria e Përgjithshme për znj. Ledina Riza për periudhën 16 janar 1999 – 31 janar 2008 dhe vërtetimi nr. *** prot., datë 24.10.2016, nga Shkolla e Magjistraturës për subjektin e rivlerësimit; vërtetim nr. *** prot, datë 18.10.2016, nga Drejtoria e Përgjithshme e Tatimeve për z. N. L. për periudhën 1997 – 2009 dhe vërtetim nr. *** prot., datë 27.10.2016, lëshuar nga Ministria e Financave si anëtar në Komisionin e Apelit të Tatimeve.

²³ Shpenzimet jetike janë përlllogaritur për 3 persona për një periudhë 6-mujore, bazuar në të dhënat zyrtare të INSTAT-it për vitin 2003. Shpenzimet e kredisë janë llogaritur gjithashtu për një periudhë 6-mujore.

marrëdhëniet më të mëhershme mes palëve – çmon se edhe mospërputhja e kuotës së pjesës takuese të tokës me shumën e paguar – për sa kohë nuk është proporcionalisht në raport të drejtë me investimin – nuk mund të përbëjë burim përgjegjësie për subjektin e rivlerësimit.

4. Apartament me sipërfaqe 55 m², në K., G./Kavajë

33. Kjo pasuri është deklaruar për herë të parë në DIPP-në e vitit 2005, e përfituar nëpërmjet kontratës nr. ***, datë 9.2.2005, kundrejt çmimit 16,000 euro. Po ashtu, në këtë vit është deklaruar edhe marrja e kredisë në shumën 1,300,000 lekë në “Alpha Bank” për blerjen e kësaj pasurie²⁴. Në deklaratën *Vetting* kjo pasuri është deklaruar me burim nga kredia e marrë në “Alpha Bank”, në masën 1,300,000 lekë dhe diferenca nga kursimet (pa specifikuar ndonjë vlerë). Është konstatuar se kontrata e kredisë me “Alpha Bank” është lidhur në datën 28.2.2005, ndërkohë që palët kanë nënshkruar kontratën e shitblerjes për këtë pasuri më 9.2.2005, në të cilën janë shprehur se çmimi prej 16,000 euro është likuiduar totalisht jashtë zyrës noteriale.
34. Komisioni i është drejtuar subjektit të rivlerësimit për të qartësuar lidhur me mospërputhjen midis datave të sipërpërmendura, në përgjigje të pyetësorit nr. 2, subjekti i rivlerësimit ka bërë me dije se ka parapaguar te pronarët e apartamentit në fjalë shumën prej 7,000 euro, në datën 27.1.2005. Për këtë parapagim është përdorur shuma prej 558,400 lekësh e tërhequr nga bashkëshorti prej llogarisë në “Raiffeisen Bank” dhe likuiditete të tjera të disponuara *cash* në banesë, të cilat ishin deklaruar në deklaratën periodike vjetore²⁵. Gjithashtu, është pohuar se për shkak të nevojës për të plotësuar diferencën, ndërkohë që kredia kërkonte kohë për t’u disbursuar, bashkëshorti ka marrë hua shumën 850,000 lekë nga shtetasi Y. L., shumë kjo e cila do t’i kthehej këtij të fundit në momentin e disbursimit të kredisë bankare nga “Alpha Bank”. Subjekti i rivlerësimit ka shtuar se pas disbursimit të kredisë në fjalë, në datën 9.3.2005, bashkëshorti ka bërë tërheqjen e shumës dhe i ka kthyer huan shtetasit Y. L..
35. Subjekti i rivlerësimit ka paraqitur bashkëngjitur përgjigjeve të pyetësorit nr. 2, dy mandatarkëtime të shumave 7,000 euro në datën 27.1.2005 dhe 1,150,000 lekë në datën 9.2.2005. Këto mandatarkëtime rezultojnë të jenë të nënshkruara nga përfaqësuesi i palës shitëse, shtetasi I. Gj.²⁶. Gjithashtu, subjekti i rivlerësimit ka deklaruar shumat e paguara për këstet e kredisë në “Alpha Bank”, në deklaratat periodike nga DIPP/2005 – DIPP/2012, në të cilën është deklaruar edhe shlyerja plotësisht e saj.
36. Lidhur me këtë pasuri, Komisioni ka administruar dokumentacionin që vijon:
- i. ASHK-ja Kavajë, me shkresën nr. *** prot., datë 11.11.2019, ka konfirmuar se në emër të shtetasve Ledina Lera dhe N. L. rezulton e regjistruar pasuria e paluajtshme e llojit apartament me sip. 55 m², nr. pasurie ***, vol. ***, f. ***, z. k. ***.
 - ii. Kontratë shitblerje, nr. ***, datë 9.2.2005, lidhur ndërmjet palës shitëse H. Sh., P. Gj., I. Gj., A. Gj., S. Gj. dhe T. Gj., të gjithë të përfaqësuar me prokurë të përgjithshme nga shtetasi F. Gj.²⁷ dhe me palë blerëse subjektin e rivlerësimit Ledina Lera dhe bashkëshortin N. L., për blerjen e pasurisë kundrejt çmimit prej 16,000 euro, likuiduar jashtë zyrës noteriale.

²⁴ Bashkëshorti i subjektit të rivlerësimit në DIPP-në e tij të vitit 2005 ka deklaruar diferencën prej 700,000 lekësh me burim nga të ardhurat.

²⁵ Në DIPP-në e vitit 2004, subjekti i rivlerësimit ka deklaruar gjendje *cash* në shumën 1,000,000 lekë.

²⁶ Shtetasi I. Gj. ka qenë një nga bashkëpronarët/shitësat e kësaj pasurie.

²⁷ Për të cilin më parë është nënshkruar prokura e përgjithshme me nr. ***, datë 27.12.2002, nga pala shitëse si më sipërcituar.

- iii. Certifikatë vërtetimi pronësie për pasurinë e paluajtshme të llojit apartament me nr. pasurie ***, në emër të subjektit të rivlerësimit dhe bashkëshortit, lëshuar në datën 22.2.2005.
- iv. Kontratë kredie, nr. ***, datë 28.2.2005, ndërmjet “Alpha Bank” dhe kredimarrësve N. dhe Ledina Lera, si dhe marrëveshje shtesë financimi nr. ***, datë 28.2.2005, lidhur ndërmjet “Alpha Bank” dhe kredimarrësve N. dhe Ledina Lera, për çeljen e kredisë me qëllim blerje apartamenti, në shumën 1,300,000 lekë dhe me afat ripagimi 7-vjeçar, shërbyer në llogarinë rrjedhëse ***²⁸.
- v. Deklaratë noteriale, nr. ***, datë 22.4.2013, ku “Alpha Bank” ka konfirmuar shlyerjen e plotë të detyrimeve të subjektit të rivlerësimit ndaj bankës dhe ka kërkuar fshirjen e hipotekës mbi pasurinë e sipërcituar²⁹.
- vi. Deklaratë noteriale, nr. ***, datë 8.5.2020, lëshuar nga shtetasi Y. L., në të cilën ka deklaruar se në javën e parë të shkurt të vitit 2005 i ka dhënë hua bashkëshortit të subjektit të rivlerësimit, shumën 850,000 lekë, pa interes dhe për një afat të shkurtër kohor. Kjo shumë i është kthyer pas disbursimit të kredisë dhe nuk është formalizuar me akt noterial, për shkak të marrëdhënieve të ngushta familjare. Huadhënësi ka deklaruar, gjithashtu, se kjo shumë e dhënë hua ishte siguruar nga kursimet e tij, në bazë të të ardhurave të aktivitetit tregtar që ushtronte në atë kohë, si ortak dhe administrator i shoqërisë “I.” sh.p.k. Mandatarkëtimi nr. ***, datë 27.1.2005, ku shtetasi Ledina dhe N. Lera kanë arkëtuar shumën 7,000 euro për blerje apartamenti dhe mandatarkëtimi nr. (jo i qartë), datë 9.2.2005, ku shtetasi N. L. ka arkëtuar shumën prej 1,150,000 lekësh për blerje apartamenti, likuidim pjesor.

4.1 Lidhur me analizimin e burimeve të krijimit të kësaj pasurie

- 37. Nga dokumentacioni i administruar ka rezultuar se kontrata e kredisë me “Alpha Bank” është nënshkruar në datën 28.2.2005, pas likuidimit të çmimit total nga subjekti i rivlerësimit (referuar kontratës së shitblerjes së datës 9.2.2005) dhe pas regjistrimit në ZVRPP të pasurisë në emër të subjektit të rivlerësimit (certifikata e pronësisë mban datën 22.2.2005).
- 38. Nga verifikimet e lëvizjeve bankare është konfirmuar tërheqja e shumës 558,400 lekë, nga llogaria e pagës së bashkëshortit të subjektit të rivlerësimit në “Raiffeisen Bank”, shumë e krijuar nga pagat dhe shpërblimet e tij nga tetor 2004 – janar 2005.
- 39. Në DIPP-në e vitit 2004, subjekti i rivlerësimit ka deklaruar gjendje *cash* në shumën 1,000,000 lekë, të cilat nga analiza e vitit 2004 mund të disponoheshin me burime të ligjshme financiare³⁰. Pas përlllogaritjes së shpenzimeve të familjes së subjektit për muajin janar të vitit 2005, rezulton se mund të dispononin kursime në masën 1,531,011 lekë, të cilat mund të mbulonin shumën 7,000 euro³¹ (ose ekuivalenti prej 857,780 lekësh), të përdorur për likuidimin e këstit të parë në datën 27.1.2005 dhe shumën 300,000³² lekë nga pagesa e këstit të dytë, siç është detajuar në tabelën në vijim të vendimit.

²⁸ Nuk është e qartë data e disbursimit të kredisë nga “Alpha Bank”, pasi referuar shkresës nr. *** prot., datë 19.12.2019, “Alpha Bank” ka vënë në dispozicion informacionet dhe të dhënat prej datës 2.3.2009 e në vijim (pas disbursimit të kredisë në fjalë), pasi ndryshimi i sistemit informatik të bankës ka sjellë që platformat e mëparshme të jenë të paaksesueshme.

²⁹ Rezulton nga kartela e pasurisë se pasuria e paluajtshme me sip. 55 m², z. k. *** dhe nr. pasurie ***, në Kavajë ka qenë e hipotekuar në favor të “Alpha Bank” me qëllim garantimin e kthimit të shumës prej 1,300,000 lekësh.

³⁰ Referojuni analizës financiare për periudhën 2003 – 2016.

³¹ Konvertuar me kursin mesatar të fundit të vitit 2005, ku 1 euro këmbehej me 122.54 lekë.

³² Nga kësti i dytë i paguar në shumën 1,150,000 lekë është marrë hua shuma 850,000 lekë dhe diferenca prej 300,000 lekësh është mbuluar me kursimet.

40. Lidhur me shumën e marrë hua prej 850,000 lekësh, Komisioni iu drejtua Drejtorisë së Përgjithshme të Tatimeve³³ lidhur me të ardhurat e realizuara nga shoqëria “I.” sh.p.k., në të cilën huadhënësi rezultoi të ketë qenë aksioner me 30% të kuotave.
41. Drejtoria Rajonale Tatimore Durrës, me shkresën nr. *** prot., datë 17.8.2020, ka informuar se kjo shoqëri për periudhën 2001– 2004, rezultoi të ketë pasur një qarkullim në shumën totale 82,444,100 lekë dhe fitim *neto* total në shumën 1,553,360 lekë, por nuk rezultoi që për këtë periudhë të ketë shpërndarë fitime në formën e dividendit.
42. Njëpërmjet përgjigjeve të pyetësorit nr. 3, subjekti i rivlerësimit ka shpjeguar se huadhënësi në cilësinë e administratorit dhe ortakut të shoqërisë “I.” sh.p.k., i ka vënë në dispozicion dy mandate tërheqje të kryera nga ky i fundit në llogaritë e shoqërisë në banka të nivelit të dytë, përkatësisht në datat 14.10.2004 dhe 15.10.2004, me shumën 1,570,000 lekë dhe 1,040,000 lekë. Po ashtu, subjekti ka paraqitur mandat tërheqje nga arka e shoqërisë nga ortaku Y. L. të shumës 900,000 lekë, datë 3.2.2005³⁴, dhe mandat depozitimi të po kësaj shume më 15.3.2005³⁵. Për të provuar burimin e ligjshëm të shoqërisë, subjekti ka paraqitur edhe pasqyrën e të ardhurave (qarkullimit) të realizuara në vitin 2005 në shumën 66,588,731 lekë.
43. Subjekti ka depozituar lëvizjet bankare të llogarisë së kredisë në “Alpha Bank”, nga ku rezultoi se shuma prej 1,277,500 lekësh³⁶ është tërhequr nga bashkëshorti në datën 9.3.2005.
44. Në mënyrë të përmbledhur është paraqitur analiza e të ardhurave që kanë shërbyer për kryerjen e pagesës së shumës 1,157,780 lekë (diferenca ndërmjet çmimit total të paguar prej 2,007,780 lekësh dhe huas së marrë prej 850,000 lekësh).

Tabela nr. 3 - Përlllogaritja e burimeve të përdorura për pagesën e kështit të parë

Likuiditetet (cash) në fund 2004	1 000 000
Pagesa e kështit të parë të apartamentit në Golem	(1 157 780)
Tërhequr nga RZB (b/sh)	558 400
Shpenzime janar 2005	(27 389)
Rezultati	373 231

Qëndrimi i subjektit të rivlerësimit

45. Pasi është njohur me rezultatet e hetimit, subjekti i rivlerësimit, veç të tjerash, lidhur me këtë pasuri, ka specifikuar se: “[...] *Burimet financiare në dispozicion ishin 1,731,174 lekë dhe jo 1,157,780 lekë, pavarësisht shumës që bashkëshorti mori nga zoti Lofca për 850,000 lekë. Meqë kredia po vonohej me qëllim për të bërë pagesën e diferencës së mjeteve që nevojiteshin, bashkëshorti morri hua për një periudhë 2-3 javore nga zoti Lofca shumën*

³³ Me shkresën nr. *** prot., datë 4.8.2020.

³⁴ Mandatpagesë nr. ***, datë 3.2.2005, me përshkrimin “Y. L. tërheqje për nevoja personale”.

³⁵ Mandatpagesë nr. ***, datë 15.3.2005, me përshkrimin “Y. L. arkëtim, kthim në llogari”.

³⁶ Shuma e mbetur nga kredia prej 1,300,000 lekësh pasi janë zbritur komisionet bankare.

850,000 lekë. Në fakt për të bërë blerjen e asetit mjaftonin 229.466 leke, por siç është shpjeguar gjykuam se duhet të kishim më shumë mjete likuide në shtëpi, për ndonjë shpenzim të paparashikuar. Kemi deklaruar saktësisht se financimi i blerjes është bërë nga kredia dhe kursimet. Paratë e z. Y. L., në shumën 229,466 lekë shërbyen për të mbuluar diferencën dy javore sa të maturohej kredia. Logjikisht aseti konsiderohet i blerë me kursime familjare dhe më kredi, pavarësisht se nga pikëpamja e likuiditetit u përdorën një pjesë e mjeteve të huajtura nga zoti Lofca për një periudhë dy-tre javore. Bashkëshorti sqaron se në deklaratën në ILDKPKI nuk është deklaruar ky kreditim 2-javor, pasi ishte transaksion marrje-dhënie brenda një periudhe të shkurtër më pak se një mujore, ndërkohë që në deklaratë deklarohen ndryshimet vjetore. Pra, bashkëshorti i cili ishte vetë deklarues, nuk kishte detyrim dhe të drejta ndaj zotit L. në datat 1.1.2005 dhe 31.12.2005, rrjedhimisht nuk kishte çfarë të deklaronte si ndryshim interesash në fillim dhe në fund të vitit. Për më tepër në deklaratën Vetting nuk gjykoj se kishte vend për deklarim në lidhje me këtë blerje, ndërkohë që në vitin 2005 bilanci familjar i fundvitit rezultonte me balancë pozitive 1,879,317 lekë sikurse e konfirmoni edhe ju në llogaritjet e bëra [...]”.

46. Gjithashtu, subjekti i rivlerësimit, në cilësinë e provës, ka paraqitur dokumentacion të datës 19.2.2021 (firmosur dhe vulosur me vulën e shoqërisë “I.” sh.p.k.), mbi lëvizjet e arkës së shoqërisë, në të cilat është e pasqyruar edhe tërheqja e ortakut Y. L. e shumës 900,000 lekë, në datën 3.2.2005 dhe kthimi i të njëjtës shumë më 15.3.2005 – që konfirmon dhe mbështet shpjegimet e subjektit të rivlerësimit.

Vlerësimi i trupit gjykues

47. Në konkluzion të analizës së dokumentacionit të administruar, të përgjigjeve dhe shpjegimeve të subjektit të rivlerësimit, si dhe të dokumentacionit provues të paraqitur nga ky i fundit, trupi gjykues vlerëson se shpjegimet dhe provat e paraqitura rezultojnë bindëse dhe çmon në përfundimin se janë provuar burimet e ligjshme të përdorura për krijimin e kësaj pasuri. Gjithsesi, pasaktësia në deklarimin e burimit mbetet, për sa kohë huamarrja afatshkurtër nga z. Y. L. nuk është përshkruar si burim në deklaratën e vitit 2005 – por kjo pasaktësi nuk mund të pasjellë pasoja për subjektin. Ky konkluzion arrihet jo vetëm në bazë dhe nën dritën e qëndrimit të konsoliduar tashmë të Kolegjit të Posaçëm të Apelimit, lidhur me pasojat e mundshme të pasaktësive në deklarimet e pasurisë, ndër vite, por edhe duke mbajtur në vëmendje faktin se përdorimi i kësaj huaje, me burime financiare të ligjshme, ka qenë për një periudhë shumë të shkurtër, në pritje të disbursimit të kredisë së lartpërmendur dhe është rikthyer brenda të njëjtë vit, pikërisht me shumën e përfituara nga kredia. Kësisoj, nisur edhe nga fakti që nuk kishte lindur detyrimi për deklarimin e huamarrjes – për sa kohë ishte kthyer mbrapsht brenda vitit 2005 – dhe vlerësuar se deklarimi i burimit nga kredia dhe kursimet, i bërë pikërisht pasi ishte marrë kredia dhe shlyer huaja, ka kuptueshmërinë e vet të logjikës deklaruese, ndonëse nuk është pasqyruar e plotë dhe e saktë, *stricto legis*, dinamika provizore dhe zëvendësuese e burimeve financiare të pagesave, në raport me momentin konkret të kryerjes së tyre.

5. Tokë truall me sipërfaqe 122 m², e trashëguar, në Ç., Korçë

48. Kjo pasuri është pjesë përbërëse e sipërfaqes së tokës prej 4,390 m², që fillimisht është përfituar nga trashëgimlënësit nëpërmjet një vendimi të KKK Pronave në vitin 1993, me numër pasurie *** dhe pjesa takuese si trashëgimtare e babait të subjektit J. R. 1/36 ose rreth 122 m², pa vlerë të deklaruar.
49. Përgjatë hetimit administrativ është konstatuar se kjo pasuri nuk është deklaruar nga subjekti i rivlerësimit në deklaratën periodike të vitit 2003, apo më pas, por e ka deklaruar këtë pasuri në deklaratën para fillimit të detyrës të bashkëshortit të vitit 2015, në rubrikën

e deklarimit të interesave të personit të lidhur, si pasuri e kthyer trashëgimtarëve të familjeve Riza. Gjithashtu, kjo pasuri është deklaruar edhe në deklaratën *Vetting*.

50. Pasuria e llojit “truall” me sip. 4,390 m² është regjistruar në ZVRPP sipas certifikatës së pronësisë lëshuar në datën 17.2.2000 dhe rezulton të jetë ndarë më pas në dy pasuri, si vijon:
- a. pasuria e llojit “truall” me nr. ***, me sip. 3,850 m² ndodhur në z. k. ***, regjistruar në emër të subjektit të rivlerësimit dhe bashkëpronarë të tjerë, ku subjekti i rivlerësimit ka në pronësi 1/36 pjesë;
 - b. pasuria e llojit “truall” me nr. ***, me sip. 540 m², ndodhur në z. k. ***, regjistruar në emër të subjektit të rivlerësimit dhe të bashkëpronarëve të tjerë, ku subjekti i rivlerësimit ka në pronësi 1/36 pjesë.
51. Për këtë pasuri, Komisioni ka administruar dokumentacionin e poshtëpërshtuar:
- i. ASHK-ja Korçë, me shkresat nr. *** prot., datë 5.11.2019 dhe nr. *** prot., datë 2.6.2020, ka konfirmuar se në bashkëpronësi të subjektit të rivlerësimit rezultojnë të regjistruara dy pasuritë e paluajtshme të llojit “truall”, përkatësisht pasuria me nr. ***, me sip. 3850 m² dhe pasuria me nr. ***, me sip. 540 m².
 - ii. Certifikatë pronësie e datës 17.2.2000 e pasurisë së llojit “truall” me sip. 4,390 m², në të cilën subjekti i rivlerësimit së bashku me nënën E. R. dhe motrën E. R. zotërojnë 1/12 pjesë të kësaj pasurie³⁷.
 - iii. Vendimi nr. ***, datë 19.7.1996, i Komisionit të Kthimit dhe Kompensimit të Pronave, ku është vendosur njohja dhe kthimi i sip. 4,390 m² ish-tokë arë dhe ku shtetaset E. R., Ledina Riza dhe A. R.³⁸ përfitojnë së bashku 1/12 pjesë³⁹.

Vlerësimi i trupit gjykues

52. Nisur nga sa rezulton, në vijim të analizës së dokumentacionit të administruar nga Komisioni, trupi gjykues mbërrin në konkluzionin se nuk janë konstatuar problematika lidhur me burimin e krijimit të kësaj pasurie. Gjithashtu, mosdeklarimi në vitin 2003, i pjesës takuese ideale të kësaj pasurie shpjegohet nga rrethanat specifike dhe tejkalohe si problematikë nga momenti që, gjithsesi, vetë subjekti e ka deklaruar këtë pasuri (ndonëse ende pa certifikatë të vërtetësisë së pronësisë veçmas, të pjesës takuese të subjektit), si në vitin 2015 dhe në deklaratën *Vetting*. Për rrjedhojë, nuk janë identifikuar problematika në lidhje me këtë pasuri.

³⁷ Pjesa tjetër është e ndarë ndërmjet bashkëpronarëve të tjerë Ll. R., Th. R., Th. R., N. R., Dh. R., P. R., M. R. dhe L. R..

³⁸ Në vendim rezulton të jetë shkruar gabim emri i motrës së subjektit të rivlerësimit, znj. E. R..

³⁹ Vendimi nr. ***, datë 18.11.2003, i Gjykatës së Rrethit Gjyqësor Korçë, në të cilin është vendosur rrëzimi i kërkesëpadisë së palës paditëse S. P. dhe K. D., me objekt ndryshimin e vendimit nr. ***, datë 19.7.1996, të KKK të Pronave; vendimi nr. ***, datë 1.7.2004, i Gjykatës së Apelit Korçë, ku është vendosur anulimi pjesërisht i vendimit nr. ***, datë 19.7.1996, të KKK të Pronave dhe është njohur pronësia e sipërfaqes prej 540 m² në emër të z. S. P., i ndryshuar me vendimin nr. ***, datë 2.11.2005, të Gjykatës së Lartë, ku është vendosur lënia në fuqi e vendimit nr. ***, datë 18.11.2003, e Gjykatës së Rrethit Gjyqësor Korçë.

6. Banesë private me sipërfaqe 69.4 m² dhe sipërfaqe trualli 78.5 m², në Rr. “K. G.”, Korçë

53. Kjo pasuri është deklaruar për herë të parë nga subjekti i rivlerësimit në deklaratën *Vetting* dhe nga bashkëshorti i subjektit në deklaratën para fillimit të detyrës në vitin 2015, në seksionin e të dhënave konfidenciale.
54. Kjo pasuri fillimisht është përfituar nga vjehri i subjektit të rivlerësimit me kontratën e shitblerjes nr. *** regj., datë 21.10.1992, të lidhur ndërmjet palës shitëse P. T. dhe A. T. dhe palës blerëse S. L., kundrejt çmimit 200,000 lekë. Pas vdekjes së këtij të fundit (trashëgimlënësi), në vitin 2011, bashkëshorti i subjektit të rivlerësimit është potencialisht trashëgimtar i 1/3 pjesë ideale të pasurisë në fjalë – në bashkëpronësi me nënën dhe motrën, ndonëse ende nuk janë kryer veprime konkrete për saktësimin e pjesëve të trashëguara për secilin trashëgimtar.
55. Në përgjigje të pyetësorit nr. 3, subjekti i rivlerësimit ka shpjeguar se kjo banesë aktualisht nuk përdoret nga askush dhe është e mbyllur prej vitësh. Për të provuar sa më sipër, subjekti ka bashkëngjitur librezën e energjisë elektrike të kësaj banese, në të cilën rezulton vetëm tarifa fikse minimale, që konfirmon mospërdorimin e pasurisë në fjalë, si dhe ka bashkëngjitur foto të gjendjes aktuale të saj.
56. Po ashtu, subjekti ka shpjeguar se banesa është ndërtuar në vitet 1982-1983, kohë në të cilën bashkëshorti ka qenë ende student pa të ardhura dhe, rrjedhimisht, nuk ka kontribuar në blerjen e pasurisë në fjalë⁴⁰.
57. Lidhur me këtë pasuri, Komisioni ka administruar dokumentacionin si vijon:
 - i. Kontratë shitblerje nr. *** regj., datë 21.10.1992, e lidhur ndërmjet palës shitëse P. T. dhe A. T. dhe palës blerëse S. L., kundrejt çmimit 200,000 lekë.
 - ii. Certifikatë pronësie e datës 13.7.2008 për pasurinë e llojit “truall” me sip. 78.5 m², nga të cilat 69.4 m² ndërtesë me nr. pasurie *** ndodhur në z. k. ***, regjistruar në emër të shtetasit S. P. L..
58. Nisur nga përmbajtja e dokumentacionit të administruar dhe analizuar, si dhe duke mbajtur në konsideratë tipologjinë e përfitimit dhe kohën e krijimit të kësaj pasurie, trupi gjykues konkludon se nuk janë konstatuar problematika lidhur me këtë pasuri.

7. Lidhur me automjetin tip “Citroen C3”

59. Ky automjet rezulton të jetë blerë në vitin 2010, në vlerën 11,600 euro dhe është deklaruar nga subjekti i rivlerësimit në DIPP-në e vitit 2010⁴¹, si dhe në deklaratën *Vetting*, me burim financiar nga të ardhurat familjare.
60. Pasuria në fjalë është përfituar me kontratën e shitblerjes lidhur në datën 20.3.2010 midis subjektit të rivlerësimit dhe palës shitëse “A.F.” sh.p.k., kundrejt çmimit 11,600 euro.
61. Lidhur me deklarimin e ekuivalentit në lekë të çmimit të blerjes prej 1,500,000 lekësh, krahasuar me çmimin që ka rezultuar në faturën e lëshuar nga shoqëria shitëse prej 1,620,868 lekësh, subjekti i rivlerësimit ka shpjeguar nëpërmjet përgjigjeve të pyetësorit

⁴⁰ Për të provuar sa më sipër, subjekti ka bashkëngjitur edhe mandatpagesat e kredisë pranë Komitetit Ekzekutiv Korçë në vitet 1984 dhe 1985 nga babai i bashkëshortit për kredinë e marrë për ndërtim dhe meremetim me fonde buxhetore.

⁴¹ Në DIPP-në e vitit 2010, subjekti i rivlerësimit ka deklaruar si vlerë të këtij automjeti shumat 11,600 euro ose 1,500,000 lekë, ndërkohë që fatura e blerjes së automjetit është në vlerën 1,620,868 lekë.

nr. 2, se ka deklaruar kundërvleftën ,duke konsideruar me kursin e këmbimit të monedhës euro kundrejt 1euro/130 lekë, ndërkohë që vlera në faturë duhet të përkojë me kursin e këmbimit të përdorur nga shoqëria shitëse. Gjithashtu, subjekti i rivlerësimit ka sqaruar se pagesa nga bashkëshorti është kryer në euro.

62. Lidhur me këtë pasuri, Komisioni ka administruar dokumentacionin si vijon:
 - i. Kontratë shitblerje lidhur në datën 20.3.2010, midis subjektit të rivlerësimit dhe palës shitëse “A. F.” sh.p.k., e përfaqësuar nga administratori S. F..
 - ii. Faturë shitje nr. ***, lëshuar nga shoqëria “A. F.” sh.p.k. për blerjen e automjetit tip “Citroen C3”, me nr. shasie ***, me një vlerë prej 1,620,868 lekësh.
 - iii. Me shkresën nr. *** prot., datë 30.10.2019, DPSHTRr-ja ka konfirmuar se në emër të subjektit të rivlerësimit rezulton i regjistruar automjeti tip “Citroen C3”, me targa TR ***, vit prodhimi 2009 dhe nr. shasie ***.
 - iv. Vërtetim, datë 28.3.2019, nga shoqëria “A. F.” sh.p.k., në të cilën kanë konfirmuar se shuma 11,600 euro është likuiduar në llogarinë e tyre bankare në “Raiffeisen Bank”, në datën 18.3.2010. Bashkëngjitur është një fletë e llogarisë bankare të shoqërisë shitëse, ku është pasqyruar pagesa prej 11,600 euro me përshkrimin “N. L. pagesë për blerje autoveture”, por ky dokument nuk është i firmosur apo vulosur nga institucioni lëshues.

7.1 Lidhur me analizimin e burimeve të krijimit të kësaj pasurie

63. Nga hetimi administrativ u konstatua se subjekti i rivlerësimit kishte deklaruar në fund të vitit 2009, kursime/tepricë në mjete monetare me të ardhurat e vitit 2009, në shumën 1,200,000 lekë.
64. Nëpërmjet pyetësorëve nr. 2 dhe nr. 3, Komisioni i ka kërkuar shpjegime subjektit të rivlerësimit lidhur me mënyrën e deklarimit të gjendjes së disponuar *cash* në banesë dhe në përgjigje të të cilëve, subjekti ka shpjeguar se likuiditetet/mjetet monetare të përshkruara në deklarimet e saj përfshijnë shumat e kursyera të ndodhura *cash* dhe shtesat e gjendjeve në llogaritë bankare, ku kryheshin transfertat e pagave mujore të punës, në pjesën që ato rezultonin të pa tërhequra përgjatë vitit të raportuar.
65. Nga verifikimi i llogarive bankare të subjektit të rivlerësimit dhe bashkëshortit ka rezultuar se gjendja në llogaritë bankare të pagave, në fund të vitit 2009, ka qenë 321,905 lekë. Referuar shpjegimeve të subjektit si më sipër, gjendja e disponuar *cash* në banesë, në fund të këtij viti konsiderohet se ka qenë shtuar me 878,095 lekë, nga të ardhurat e vitit 2009 dhe së bashku me kursimet e mbartura nga viti 2008⁴² do të rezultonte një total i disponuar *cash* në masën 1,178,095 lekë.
66. Nisur nga fakti që pagesa për blerjen e automjetit është kryer *cash* në llogarinë e shoqërisë shitëse “A. F.” sh.p.k., në datën 18.3.2010, Komisioni verifikoi të gjitha tërheqjet në llogaritë bankare të subjektit të rivlerësimit dhe bashkëshortit, duke filluar nga data 1 janar 2010 deri në datën e pagesës 18.03.2010, të cilat rezultuan në masën totale prej 468,900 lekësh.
67. Pas përlllogaritjes dhe të shpenzimeve jetike për një periudhë 2 mujore të vitit 2010 dhe shpenzimeve të shlyerjes së kredive dhe kartës së kreditit të kryera nga subjekti i rivlerësimit dhe bashkëshortit për të njëjtën periudhë⁴³, ka rezultuar se për shlyerjen e

⁴² Të cilat janë deklaruar në DIPP-në e vitit 2008, në shumën 300,000 lekë.

⁴³ Shuma 38,000 lekë paguar kredia në “Raiffeisen Bank”, shuma 55,000 lekë paguar kredia në “Alpha Bank” dhe shuma 5,500 lekë paguar karta e kreditit të bashkëshortit në BKT.

shumës prej 11,600 euro (ose ekuivalentit prej 1,610,196 lekë⁴⁴), subjekti i rivlerësimit ka pasur një mungesë të burimeve të ligjshme financiare në masën -130,011 lekë. Në mënyrë të përmbledhur është paraqitur analiza financiare e kryer nga Njësia e Shërbimit Ligjor të Komisionit, mbi të ardhurat e disponueshme me burime të ligjshme, për të mundësuar blerjen e automjetit në analizë, në datën 18.3.2010.

Tabela nr. 4 - Përlllogaritja e burimeve të përdorura për blerjen e kësaj pasurie

Terheqje nga llogarite deri 18.03.2010	468 900
Blerja automjetit Citroen C3	(1 610 196)
Likuiditete (cash) ne fund 2009	1 178 095
Shpenzime janar-shkurt 2010	(166 810)
Rezultati	(130 011)

Qëndrimi i subjektit të rivlerësimit

68. Pasi është njohur me rezultatet e hetimit, lidhur me këtë pasuri – për të cilat i ishte kaluar barra e provës – subjekti i rivlerësimit, veç të tjerash, ka pohuar se: “[...] Në vitin 2010, KFF ka bërë shpërndarjen e dividendit për fitimet e vitit 2009. Tërheqja nga banka e shumës 10,000 euro është bërë në 23.03.2010. Meqenëse një javë para tërheqjes së dividendit kishim vendosur të blinim automjetin tip ‘Citroen C3’, i cili shitej me ofertë pasi ishin copët e fundit, bashkëshorti ka tërhequr nga llogaria e arkës së biznesit të vet ‘K.’ sh.p.k., 2,500 euro në formë paradhënie, të cilat i ka rikthyer në llogarinë e arkës së biznesit pas tërheqjes së dividendit nga banka. Arka e biznesit K. sh.p.k., kishte vazhdimisht gjendje mjeteve monetare. Pra, blerja e automjetit ka qenë e mbuluar plotësisht me mjete monetare në dispozicion për këtë blerje. Pjesa e dividendit, të marrë 5 ditë më vonë, shërbeu për të kompensuar cash-in e konsumuar për këtë blerje [...]”.
69. Gjithashtu, subjekti i rivlerësimit ka paraqitur një analizë financiare, për këtë vit/pasuri, duke shtuar disponibilitetin e mjeteve monetare për atë periudhë, me shumën prej 2,500 euro, nga ku ka rezultuar një bilanc pozitiv prej 217,014 lekësh, si dhe ka depozituar në cilësinë e provës edhe dokumentacionin e listuar në vijim:
- i. Lëvizjet bankare të llogarisë së shoqërisë “K.” sh.p.k., në BKT, nga ku janë konstatuar tërheqjet: në datën 13.1.2010 tërheqje në shumën 3,000 euro; në datën 2.3.2010 tërheqje në shumën 6,000 euro dhe në datën 23.3.2010 tërheqje në shumën 5,000 euro, për të provuar ekzistencën e likuiditeteve në arkën e shoqërisë.
 - ii. Mandatpagesa nr. ***, datë 16.3.2010, në favor të z. N. L., me përshkrimin “ortaku parapagim dividendi”, të shumës prej 2,500 euro nga arka e shoqërisë.
 - iii. Mandatarkëtimi nr. ***, datë 30.3.2010, me përshkrimin “kthim ortaku dividend paradhënie”, të shumës 2,500 euro në arkën e shoqërisë.
 - iv. Vërtetim, datë 18.2.2021, lëshuar nga shoqëria “K.” sh.p.k., në të cilën konfirmohet se ortaku N. L. ka tërhequr nga arka e shoqërisë shumën 2,500 euro paradhënie dividendi në datën 17.3.2010 dhe i ka rikthyer më 30.3.2010.
 - v. Lëvizjet e arkës së vitit 2010, në *excel*, në të cilën, ndër të tjera, janë pasqyruar edhe veprimet e sipërcituara në datën 17.3.2010 dhe kthimi më 30.3.2010.

⁴⁴ Referuar kursit mesatar të këmbimit të fundit të vitit 2010, ku 1 euro këmbëhej me 138.81 lekë.

Vlerësimi i trupit gjykues

70. Trupi gjykues, nisur nga deklaratimet, shpjegimet dhe provat e depozituara nga subjekti i rivlerësimit, vlerëson se pretendimet e subjektit lidhur me burimin financiar prej 2.500 euro të përdorur për blerjen e automjetit në analizë nuk arrijnë një nivel të mjaftueshëm provueshmërie dhe rrjedhimisht besueshmërie. Ky konkluzion mbështetet në faktet që: (i) pikë së pari është konstatuar një mospërputhje midis datës 16.3.2010 të mandatpagesës me datën e pasqyrimit të veprimit më 17.3.2010, në arkën e shoqërisë “K.” sh.p.k., ndonëse pagesa e automjetit në llogarinë e shoqërisë shitëse është kryer në datën 18.3.2010 dhe kjo nuk e përjashton përdorimin e tyre me atë destinacion; (ii) ky burim financiar, i pretenduar si i tërhequr nga shoqëria “K.” sh.p.k., nuk është deklaruar nga subjekti në DIPP e vitit 2010, as në deklaratën *Vetting* dhe as përgjatë hetimit administrativ – por është pretenduar për herë të parë vetëm pas njoftimit të rezultateve të hetimit, nëpërmjet shpjegimeve dhe prapësimeve përfundimtare të subjektit; (iii) shoqëria “K.” sh.p.k. ishte e bashkëshortit të subjektit dhe, për rrjedhojë, mungon konfirmimi i faktit/veprimit të pretenduar nga një palë e tretë, apo nga dokumentacion provues në mënyrë shteruese; (iv) shuma prej 2.500 euro, e pretenduar si një burim financiar i ndërmjetëm, rezulton të përkojë me trefishin e nevojave reale (sipas analizës financiare), fakt ky që e zbeh besueshmërinë lidhur me përdorimin e saj në destinacionin e pretenduar. Në këtë pikë, trupi gjykues çmon se – ndonëse shuma e sipërcituar (prej 2.500 euro), nuk do të merret në konsideratë si burim krijimi për këtë pasuri dhe bilanci negativ lidhur me këtë blerje mbetet në shumën 130.011 lekë – nisur nga vlera minimale e pamundësisë financiare në fjalë dhe në këndvështrimin e parimit të proporcionalitetit, nuk mund të passjellë pasoja për subjektin e rivlerësimit.

8. Huadhënie pa interes në masën 1,000,000 lekë, dhënë nënës së subjektit të rivlerësimit në vitin 2008, me burim krijimi nga të ardhurat familjare

71. Në DIPP-në e vitit 2008, subjekti i rivlerësimit ka deklaruar se në gusht të vitit 2008 i ka dhënë nënës E. R., shumën prej 1,000,000 lekësh, nga kursimet e saj dhe të bashkëshortit, ndërsa në deklaratën *Vetting* ka deklaruar dhënie huaje pa interes në shumën 1,000,000 lekë, me burim nga të ardhurat familjare dhe se është dhënë në mirëbesim, pa kontratë.
72. Në përgjigje të pyetësorit nr. 2, bashkëshorti i subjektit të rivlerësimit ka sqaruar se i ka dhënë vjehrrës së tij (nënës së subjektit të rivlerësimit) huan në shumën 1,000,000 lekë, me burim nga të ardhurat e familjes dhe se kjo hua nuk është kthyer.

8.1 Lidhur me analizimin e burimit të krijimit të shumës, de qua, të dhënë hua

73. Nisur nga deklarimi i subjektit të rivlerësimit se huaja në fjalë, në shumën 1,000,000 lekë, është dhënë në gusht të vitit 2008, Komisioni përlllogariti mundësitë financiare të familjes së subjektit të rivlerësimit deri në korrik të vitit 2008.
74. Nga verifikimi i lëvizjeve bankare të subjektit të rivlerësimit dhe bashkëshortit, u konstatuan se tërheqjet nga llogaritë e tyre deri në fund të muajit korrik kanë qenë në masën 1,744,600 lekë. Subjekti i rivlerësimit ka deklaruar në DIPP-në e vitit 2007 gjendjen e disponuar *cash* në banesë në masën 900,000 lekë. Komisioni përlllogariti shpenzimet e familjes gjatë periudhës janar – korrik 2008, në masën 858,800 lekë⁴⁵.
75. Gjithashtu, Komisioni ka konsideruar në analizë edhe investimin e kryer nga subjekti i rivlerësimit për blerjen e automjetit tip “Chevrolet S.”, sipas faturës tatimore nr. ***, datë

⁴⁵ Janë përlllogaritur shpenzimet e udhëtimit deri në korrik të vitit 2008, në masën 522 euro (64,301 lekë), shpenzimet për shkollimin e vajzës 283,580 lekë, shpenzime jetese për 7 muaj të vitit 2008 për 3 persona dhe shpenzimet e kredive në “Raiffeisen Bank” dhe “Alpha Bank”.

1.3.2008, në të cilën shoqëria “A.” sh.p.k. i ka shitur automjetin e përdorur subjektit të rivlerësimit, kundrejt çmimit 500,000 lekë.

76. Në mënyrë të përmbledhur është paraqitur analiza e burimeve financiare dhe e shpenzimeve të familjes së subjektit të rivlerësimit, rezultati i së cilës konfirmon mundësinë e disponibilitetit të mjeteve monetare me burime të ligjshme për dhënien e huas në shumën 1,000,000 lekë, në gusht të vitit 2008.

Tabela nr. 5 - Përlllogaritja e burimeve të përdorura për dhënien e huas

Terheqje nga llogarite deri 31.07.2008	1 744 600
Likuiditete (cash) ne fund 2007	900 000
Blerja automjetit Chevrolet	(500 000)
Dhene hua ne nes se SR	(1 000 000)
Shpenzime deri korrik 2008	(858 800)
Rezultati	285 800

77. Nisur nga sa më sipër dhe, veçanërisht, nga analiza financiare e kryer nga Njësia e Shërbimit Ligjor të Komisionit, trupi gjykues vlerëson se familja e subjektit të rivlerësimit ka pasur mundësi për dhënien hua të shumës 1,000,000 lekë gjatë vitit 2008, me burime të ligjshme financiare.

9. Lidhur me disa depozita kursimi në emër të subjektit të rivlerësimit dhe të bashkëshortit:

a. Lidhur me shumën 10,000 euro, depozitë kursimi në BKT, në emër të bashkëshortit të subjektit të rivlerësimit dhe vajzës, çelur më 4.1.2012, me burim krijimi nga të ardhurat familjare

78. Depozita në shumën 10,000 euro është deklaruar nga subjekti i rivlerësimit në DIPP-në e vitit 2011⁴⁶, në emër të shtetasve N. dhe W.⁴⁷ me burim nga kursimet.
79. Depozita e çelur në datën 4.1.2012, konstatohet se rrjedh nga të ardhurat nga dividendët e shpërndarë të vitit 2010, nga aktiviteti i bashkëshortit të subjektit të rivlerësimit, nga të cilat ka përfituar shumën prej 31,500 euro, transferuar në llogarinë e tij në BKT në datën 26.4.2011⁴⁸. Nga këto fonde⁴⁹ është çelur depozita në fjalë në datën 4.1.2012.
80. Referuar shkresës kthim përgjigje nr. *** prot., datë 8.7.2020, nga Drejtoria e Hetimit Tatimor, shoqëria “K.” sh.p.k. gjatë vitit 2010 ka realizuar të ardhura në masën 20,530,474 lekë dhe fitim *neto* në vlerën 9,567,026 lekë⁵⁰.
81. Bashkëshorti i subjektit të rivlerësimit ka vënë në dispozicion në përgjigje të pyetësorit nr. 2 një vërtetim (pa datë) të lëshuar nga administratori aktual i shoqërisë, z. F. K., në të cilin

⁴⁶ Duket se është deklaruar në DIPP-në e vitit 2011, duke qenë se çelja e depozitës është bërë përpara dorëzimit të deklaratës më 23.3.2012.

⁴⁷ Bashkëshorti i subjektit të rivlerësimit dhe vajza e tyre.

⁴⁸ Bashkëshorti i subjektit të rivlerësimit i ka shitur kuotat e kësaj shoqërie sipas kontratës nr. ***, datë 4.5.2015 shtetasit F. K., kundrejt çmimit prej 160,000 lekësh. Bashkëshorti i subjektit të rivlerësimit ka realizuar fitim nga kjo shitje në masën 60,000 lekë (nga vlera nominale prej 100,000 lekësh), fitim të cilin e ka deklaruar në DIVA të vitit 2015 dhe për të cilin ka paguar detyrimin tatimor në datën 29.4.2016, nga llogaria e tij në BKT, në masën 9,001 lekë.

⁴⁹ Pas tërheqjeve të shumave prej 16,000 euro, në datën 18.7.2011; 3,000 euro, në datën 14.9.2011 dhe 1,000 euro në datën 6.12.2011 nga bashkëshorti i subjektit.

⁵⁰ Referuar vendimit të asamblesë datë 12.7.2011 për Drejtorinë Rajonale Tatimore Tiranë, ky fitim është shpërndarë përkatësisht 2,750,000 lekë në dhjetor të vitit 2010 dhe pjesa tjetër në prill të vitit 2011. Shoqëria ka paguar tatimin mbi dividendin sipas mandatpagesave datë 30.12.2010, në shumën 275,000 lekë dhe datë 26.4.2011, në shumën 680,000 lekë.

ka konfirmuar dividendët e përfituar nga z. N. L. gjatë viteve. Gjithashtu, ka bashkëngjitur bilancet e shoqërisë për vitet 2009 – 2015 (vite në të cilat shtetasi N. L. ka qenë ortak pranë kësaj shoqërie), vendimet e asamblesë së ortakëve për shpërndarjen e dividendëve dhe transfertat bankare përkatëse, përgjatë kësaj periudhe.

82. Drejtoria Rajonale Tatimore Tiranë ka konfirmuar me shkresën nr. *** prot., datë 23.1.2020, se shoqëria “K.” sh.p.k. ka shpërndarë fitime në shumën 29,341,888 lekë dhe ka paguar tatim mbi dividendin në shumën 2,880,138 lekë.
- b. Lidhur me shumën 10,000 USD, depozitë kursimi në “Raiffeisen Bank”, në emër të bashkëshortit të subjektit të rivlerësimit, çelur më 25.5.2012 (më pas rinovuar në vitin 2014), me burim nga të ardhurat familjare*
83. Depozita në shumën 10,000 USD është deklaruar nga subjekti i rivlerësimit në DIPP-në e vitit 2012, në emër të bashkëshortit, me burim nga kursimet e kaluara.
84. Nga verifikimi i lëvizjeve bankare është konstatuar se kjo depozitë është çelur në datën 25.5.2012, nga bashkëshorti në “Raiffeisen Bank”.
85. Subjekti i rivlerësimit ka deklaruar, në fund të vitit 2011, tepriçë në mjetet monetare nga të ardhurat familjare të vitit 2011, në masën 3,000,000 lekë. Referuar përgjigjeve të subjektit të rivlerësimit të pyetësorëve nr. 2 dhe 3, kjo shumë përmban likuiditetet në bankë dhe *cash*, të kursyera vetëm me anë të të ardhurave të atij viti.
86. Në këto kushte, nga lëvizjet bankare konstatohet se subjekti së bashku me bashkëshortin, në fund të vitit 2011 kanë pasur gjendje në llogaritë e tyre të të ardhurave (ku përfshihen llogaritë e pagave dhe llogaria e dividendëve të bashkëshortit) shumën 1,697,959 lekë. Nga shuma totale e likuiditeteve të kursyera me të ardhurat e vitit 2011, prej 3,000,000 lekësh, rezulton se gjendja e disponuar *cash* në banesë, nga këto të ardhura, ka qenë në vlerën 1,302,041 lekë, duke shtuar edhe kursimet e disponuara *cash* në banesë në fund të vitit 2010, të cilat janë deklaruar nga subjekti në DIPP-në e vitit 2010, në shumën 1,100,000 lekë⁵¹, rezulton se gjendja totale e disponuar *cash* në banesë në fund të vitit 2011, ka qenë 2,402,041 lekë.
87. Duket se kjo shumë e disponuar *cash* në fund të vitit 2011 është e mjaftueshme për të mbuluar shumën e investuar në depozitë me afat prej 10,000 USD (ose ekuivalenti prej 1,065,700 lekësh) në vitin 2012, me kursimet e kaluara.
- c. Lidhur me shumën 20,000 euro, në depozitë kursimi në BKT, në emër të bashkëshortit të subjektit të rivlerësimit, të çelur më 14.1.2013, me burim nga të ardhurat familjare*
88. Depozita në shumën 20,000 euro është deklaruar nga subjekti i rivlerësimit në DIPP-në e vitit 2013, në emër të bashkëshortit, me burim nga kursimet e kaluara në BKT.
89. Nga verifikimi i llogarive bankare është konstatuar se kjo depozitë në shumën 43,509 euro është krijuar nga gjendja në llogarinë e bashkëshortit të subjektit të rivlerësimit në BKT, në momentin e krijimit të kësaj depozite. Kjo gjendje rezulton të jetë krijuar nga transferimi i shumës 24,700 euro në datën 2.8.2012, nga shoqëria “K.” sh.p.k. për dividendin e vitit 2011 dhe nga tri depozitime *cash* të shumës totale prej 19,500 euro⁵² kryer nga bashkëshorti i subjektit të rivlerësimit në dhjetor të vitit 2012.
90. Në përgjigje të pyetësorit nr. 2, subjekti i rivlerësimit ka shpjeguar se këto derdhje në shumën 19,500 euro rrjedhin nga të ardhurat e deklaruara më parë dhe të taksuara.

⁵¹ Deklaruar në DIPP-në e vitit 2010, me përshkrimin “kursime *cash*”.

⁵² Shuma 9,000 euro në datën 17.12.2012; 5,000 euro në datën 20.12.2012 dhe 5,500 euro në datën 26.12.2012.

Bashkëshorti i subjektit të rivlerësimit ka shpjeguar se gjatë viteve 2010 dhe 2011 ka kryer tërheqje përkatësisht të shumave 20,000 euro (10,000 euro, datë 25.3.2010 dhe 10,000 euro, datë 9.4.2010) dhe 20,000 euro (16,000 euro, datë 18.7.2011; 3,000 euro, datë 14.9.2011 dhe 1,000 euro, datë 6.12.2011) dhe se arsyet e tërheqjes së këtyre fondeve kanë qenë përkatësisht për blerjen e automjetit tip “Citroen C.” kryer gjatë vitit 2010⁵³ dhe për arsye administrimi. Më pas, në vitin 2012 ka kryer riderdhjen e këtyre shumave në bankë, për t’i investuar në depozita kursimi.

91. Referuar deklaramëve të subjektit të rivlerësimit në DIPP-të përkatëse dhe shpjegimeve të dhëna në përgjigje të pyetësorëve nr. 2 dhe 3, mbi gjendjen e disponuar *cash* në banesë, ka rezultuar se në fund të vitit 2010 kjo gjendje ka qenë në shumën 1,100,000 lekë⁵⁴ dhe në fund të vitit 2012, në shumën totale 2,402,041 lekë. Pas investimit në maj të vitit 2012 të depozitës prej 10,000 USD (ose ekuivalenti prej 1,065,700 lekë), për të cilën burimi është deklaruar nga këto kursime, rezulton se gjendja e mbetur do të ishte në shumën 1,336,341 lekë.
92. Nga verifikimi i të gjitha llogarive bankare të subjektit të rivlerësimit dhe bashkëshortit, rezultoi se gjatë vitit 2012 kanë tërhequr *cash* shumën totale prej 2,366,884 lekësh. Komisioni për llogaritë nga këto tërheqje shpenzimet e familjes në masën 966,955 lekë⁵⁵, si dhe është derdhur për pagesa të kredive dhe të kartës së kreditit të bashkëshortit shuma totale prej 271,500 lekësh⁵⁶.
93. Pas zbritjes së shpenzimeve të kryera gjatë vitit ka rezultuar se me shumën e tërhequr *cash* nga subjekti dhe bashkëshorti gjatë vitit 2012, ata mund të kursenin me burime të ligjshme financiare shumën 1,128,429 lekë.
94. Në përfundim të sa më sipër, e gjithë shuma e mundshme për t’u disponuar *cash* nga subjekti dhe bashkëshorti, nga kursimet e vitit dhe ato të viteve të kaluara, rezulton të ketë qenë 2,464,770 lekë. Në këto kushte, për depozitim e shumës prej 19,500 euro (ekuivalenti prej 2,724,540 lekësh) në fund të vitit 2012, duket se subjekti dhe bashkëshorti kanë pasur një mungesë të burimeve të ligjshme në masën -259,770 lekë.
95. Në DIPP-në e vitit 2012, subjekti ka deklaruar tepriçë të mjeteve monetare në shumën 25,000 euro (ose ekuivalenti prej 3,493,000 lekësh). Duke konsideruar se gjendja e disponuar *cash* në vitin e mëparshëm u përdor për çeljen e depozitës bankare në vitin 2012 dhe depozitim e shumës prej 19,500 euro në po këtë vit, rrjedhimisht kjo shumë nuk mund të mbartej në vitin pasardhës. Po ashtu, edhe nëse do të konsiderohej shtesë e mbartur, në fund të këtij viti, gjendja e llogarive bankare do të rezultonte më e lartë se të dy këto vlera të mbledhura bashkë. Në këto kushte, duket se ka një pasaktësi në deklarin e subjektit të rivlerësimit, sa i përket gjendjes së kursimeve të disponuara dhe Komisioni ka marrë në konsideratë për këtë vit gjendjen e pretenduar prej 6,500 euro nga subjekti i rivlerësimit në përgjigje të pyetësorit nr. 3.

⁵³ Automjeti tip “Citroen C.” rezulton të jetë paguar nga bashkëshorti i subjektit në datën 18.3.2010, referuar dhe lëvizjeve bankare të shoqërisë shitëse, pra, përpara se fondet nga dividendi të transferoheshin në llogarinë e bashkëshortit të subjektit të rivlerësimit në datën 24.3.2010 dhe të tërhiqeshin më 25.3.2010, çka tregon se këto fonde nuk mund të ishin përdorur për blerjen e automjetit.

⁵⁴ E cila është mbartur edhe në fund të vitit 2012.

⁵⁵ Ku përfshijnë shpenzimet e jetesës në shumën 423,072 lekë për një familje me tre pjesëtarë referuar standardit të përdorur nga ILDKPKI-ja; shpenzimet e shkollimit të vajzës në shumën totale 346,500 lekë referuar vërtetimit nr. *** prot., datë 16.11.2020, nga shkolla jopublike “F.”; shpenzime siguracioni 14,000 lekë dhe shpenzime udhëtimi në shumën 183,383 lekë, ku referuar raportit të hyrje-daljeve, gjatë këtij viti është kryer vetëm një udhëtim nga familja e subjektit për në Barcelonë, me shpenzime të përlllogaritura në masën 1,313 euro.

⁵⁶ Nga të cilat 228,000 lekë derdhur për pagesën e kredisë në “Riaffeisen Bank”; 42,500 lekë derdhur për pagesën e kredisë në “Alpha Bank” dhe 1,000 lekë derdhur për kartën e kreditit të bashkëshortit në BKT.

96. Gjithashtu, në vijim të sa më sipër, rezulton një pamundësi për të kursyer, më tej, shumën 6,500 euro (ekuivalenti prej 908,180 lekësh), si kursime *cash* në fund të të njëjtit vit. Nga analiza financiare e vitit 2012, në të cilën janë konsideruar të gjitha të ardhurat e vitit, likuiditetet dhe shpenzimet e kryera, është konstatuar se për kryerjen e të gjitha investimeve në depozitat e kursimit apo në llogaritë rrjedhëse, shpenzimeve të vitit dhe kursimeve të pretenduara *cash* dhe në bankë, subjekti i rivlerësimit duket se ka pasur një mungesë të burimeve të ligjshme financiare në masën -1,198,942 lekë⁵⁷, si në tabelën që vijon.

Tabela nr. 6 - Analiza e të ardhurave dhe shpenzimeve të vitit 2012

Te ardhurat e vitit 2012	5 547 071
Likuiditetet ne banke ne fillim te vitit 2012	4 373 681
Likuiditetet ne banke ne fund te vitit 2012	(11 368 689)
Pakesimi i gjendjes cash	1 493 861
Shpenzime te vitit 2012	(1 244 866)
Rezultati i vitit	(1 198 942)

d. Lidhur me shumën 1,175,000 lekë, në depozitë kursimi në “Raiffeisen Bank”, në emër të subjektit të rivlerësimit, çelur më 3.8.2015, me fondet e tërhequra nga “Alpha Bank” dhe me burim krijimi nga të ardhurat familjare

97. Depozita në shumën 1,175,000 lekë është deklaruar nga subjekti i rivlerësimit në DIPP- në e vitit 2015, por nuk është përcaktuar burimi i krijimit të saj. Gjithashtu, është deklaruar mbyllja e depozitës prej 1,148,000 lekësh në “Alpha Bank”, por pa u specifikuar që këto fonde kanë shërbyer për çeljen e depozitës së re në “Raiffeisen Bank”. Kjo e fundit është deklaruar vetëm në deklaratën *Vetting*.

98. Depozita në “Alpha Bank”⁵⁸ rezulton të jetë çelur fillimisht në vitin 2008 nga subjekti i rivlerësimit, në dy kontrata nga 500,000 lekë/secila⁵⁹. Në DIPP- në e vitit 2008, subjekti i rivlerësimit ka deklaruar çeljen e dy depozitave në fjalë, ku njëra prej tyre ka pasur burimin nga depozita e tërhequr në “Raiffeisen Bank”, ndërsa për depozitën e dytë nuk rezulton të jetë deklaruar burimi i krijimit. Depozita e parë është çelur fillimisht në “Raiffeisen Bank” në datën 8.8.2006⁶⁰. Nga analiza financiare⁶¹ duket se subjekti ka pasur mundësi për çeljen e këtyre depozitave në vitet 2006 dhe 2008, në shumën 500,000 lekë/secila, me burime të ligjshme financiare.

e. Lidhur me shumën 945,000 lekë, depozitë kursimi në BKT, në emër të bashkëshortit të subjektit të rivlerësimit, çelur më 21.12.2016, me burim krijimi nga fondet e bonove të thesarit në maj të vitit 2016

99. Depozita në shumën 945,000 lekë është deklaruar nga bashkëshorti i subjektit të rivlerësimit në DIPP- në e vitit 2016, me burim nga kursimet. Nga lëvizjet bankare ka rezultuar se shuma prej 945,000 lekësh është kaluar në depozitë me afat në datën 21.12.2016 dhe se kjo shumë rrjedh nga maturimi i bonove të thesarit në datën 28.4.2016,

⁵⁷ Ka një diferencë prej 30,992 lekësh (midis analizës së vitit 2012 prej – 1,198,942 me mungesën e burimeve të ligjshme të konstatuar prej – 1,167,950 lekësh), e cila vjen nga interesat dhe komisionet bankare, të cilat rrjedhin nga të ardhura të vitit, të pa tërhequra dhe pagesa të kryera nga subjekti i rivlerësimit nga llogaria e pagës për shoqërinë “V.” sh.a.

⁵⁸ Depozita në shumën 1,148,000 lekë në “Alpha Bank”, me fondet e së cilës deklarohet të jetë çelur depozita në “Raiffeisen Bank”.

⁵⁹ Në total shuma 1,000,000 lekë.

⁶⁰ Konstatohet nga lëvizjet bankare të subjektit të rivlerësimit se në këtë datë ka tërhequr nga llogaria e saj e pagës në “Raiffeisen Bank” shumën 459,100 lekë, gjendje kjo e krijuar nga pagat.

⁶¹ Referojuni analizës financiare për periudhën 2003 – 2016.

të cilat janë transferuar në llogarinë e bashkëshortit të subjektit të rivlerësimit në shumën 985,017.83 lekë dhe një derdhje *cash* e kryer nga bashkëshorti i subjektit në shumën 141,000 lekë, në datën 21.12.2016.

100. Lidhur me shumën 141,000 lekë të derdhur nga bashkëshorti, nga verifikimi i llogarive të pagave të subjektit dhe bashkëshortit, është konstatuar se gjatë dhjetorit të vitit 2016 deri në datën e derdhjes kanë tërhequr shumën totale prej 250,000 lekësh, të cilat mjaftojnë për të justifikuar derdhjen e shumës 141,000 lekë.
101. Bonot e thesarit janë investuar për herë të parë në shumën 1,000,000 lekë, në datën 8.4.2014 (transferuar nga llogaria e bashkëshortit në “Credins Bank”, në datën 31.3.2014) me maturim 1-vjeçar. Më pas, kjo shumë është riinvestuar edhe në vitin 2015. Në DIPP-në e vitit 2014, bashkëshorti i subjektit të rivlerësimit ka deklaruar investimin e bonove të thesarit me burim nga të ardhurat e kursyera në vite. Komisioni ka kryer një analizë mbi mundësitë e subjektit të rivlerësimit dhe bashkëshortit për të disponuar shumën prej 1,000,000 lekësh, në datën 28.3.2014, kur është bërë derdhja *cash* nga bashkëshorti në llogarinë e tij në “Credins Bank”.
102. Gjithashtu, subjekti i rivlerësimit ka deklaruar në DIPP-në e vitit 2013, gjendjen *cash* në fund të vitit prej 300,000 lekësh me të ardhurat e vitit, ndërkohë bashkëshorti në rubrikën e personit të lidhur ka deklaruar gjendjen *cash* prej 8,000 euro⁶² me të ardhurat nga vitet e kaluara. Nga analiza e kryer në paragrafin 96, shuma prej 6,500 euro nuk mund të disponohej në fund të vitit 2012 me burime të ligjshme financiare.
103. Po ashtu, nga analiza financiare e vitit 2013, pas konsiderimit të të ardhurave, shpenzimeve dhe investimeve të kryera nga subjekti dhe bashkëshorti në llogaritë bankare, rezulton se për të mbartur gjendjen *cash* prej 6,500 euro dhe kursyer edhe shumën prej 1,500 euro dhe 300,000 lekë (të deklaruara këto në DIPP-në e vitit 2013⁶³) në fund të vitit 2013, subjekti ka pasur një mungesë të burimeve të ligjshme në masën – 944,946 lekë, siç është detajuar në tabelën në vijim.

Tabela nr. 7 - Analiza financiare e vitit 2013

Te ardhurat e vitit 2013	1 971 523
Gjendja ne banke ne fillim te vitit 2013	11 368 689
Gjendja ne banke ne fund te vitit 2013	(12 345 666)
Shpenzime te vitit 2013	(1 198 373)
Shpenzime per pagesen e kredise	(227 619)
Rritja e gjendjes cash nga 2012 ne 2013	(513 500)
Rezultati i vitit	(944 946)

104. Rrjedhimisht, duket se subjekti dhe bashkëshorti, në fund të vitit 2013, mund të dispononin me burime të ligjshme financiare kursimet *cash* në shumën 476,734 lekë⁶⁴. Komisioni ka përlllogaritur në vijim në analizë, si kursime të ligjshme, shumën 476,734 lekë *cash*, si dhe ka marrë në analizë edhe tërheqjet nga llogaritë bankare të subjektit dhe të bashkëshortit,

⁶² Subjekti ka shpjeguar në përgjigje të pyetësorit nr. 3, se shuma prej 8,000 euro përbëhet nga gjendja në fund të vitit të kaluar, 2012, të kursimeve *cash* prej 6,500 euro, si dhe 1,500 euro të tërhequra nga bashkëshorti në datat 28.1.2013, 31.1.2013 dhe 8.2.2013.

⁶³ Në DIPP-në e vitit 2013 subjekti i rivlerësimit ka deklaruar tepriçë të mjeteve monetare në vlerën 300,000 lekë *cash*, ndërkohë në rubrikën e personit të lidhur bashkëshorti ka deklaruar gjendje *cash* nga të ardhurat e viteve të kaluara 8,000 euro. Në analizën e vitit janë konsideruar të dyja vlerat si të disponuara *cash* nga familja në fund të vitit 2013.

⁶⁴ Për sa kohë për të disponuar kursimet në shumën 1,421,680 lekë, subjekti kishte një mungesë të burimeve të ligjshme prej 944,946 lekësh.

në vitin 2014 deri në datën 28.3.2014, të cilat kanë rezultuar në masën 354,000 lekë. Për të depozituar shumën prej 1,000,000 lekësh në datën 28.3.2014, pas zbritjes së shpenzimeve të së njëjtës periudhë ka rezultuar një pamjaftueshmëri financiare në shumën 372.265 lekë, siç është pasqyruar në tabelën vijuese.

Tabela nr. 8 - Përlllogaritja e të ardhurave të përdorura për investimin

Terheqje nga llogarite deri 28.03.2014	354 000
Depozitimi shumes 1,000,000 Leke	(1 000 000)
Likuiditete (cash) ne fund 2013	476 734
Shpenzime jetese/kredie janar-mars 2014	(202 999)
Rezultati	(372 265)

105. Pasi janë analizuar dhe vlerësuar të gjitha të dhënat e administruara deri në momentin e mbylljes së hetimit administrativ dhe janë përlllogaritur nga Njësia e Shërbimit Ligjor të Komisionit burimet financiare, shpenzimet dhe investimet e kryera nga familja e subjektit të rivlerësimit, këtij të fundit i ka kaluar barra e provës dhe i janë njoftuar rezultatet e mëposhtme – lidhur me të gjitha depozitat financiare të sipërpërkshkruara:

- i. Duket se subjekti i rivlerësimit ka pasur mundësi për investimet e kryera në vitin 2012 të depozitave, përkatësisht 10,000 euro (ose ekuivalenti prej 1,397,200 lekësh) dhe 10,000 USD (ose ekuivalenti prej 1,065,700 lekësh) me burime të ligjshme financiare.
- ii. Nga analiza financiare duket se subjekti i rivlerësimit ka pasur mundësi në vitet 2006 dhe 2008, për krijimin me burime të ligjshme financiare të depozitave me vlerë prej 500,000 lekësh secila, të përdorura për çeljen e depozitës në shumën 1,175,000 lekë.
- iii. Duket se subjekti i rivlerësimit ka pasur një mungesë të burimeve të ligjshme financiare prej -259,770 lekësh, për të mundësuar depozitimin e shumës prej 19,500 euro në dhjetor të vitit 2012, të cilat më pas janë përdorur për të çelur një tjetër depozitë në shumën 20,000 euro, në janar të vitit 2013.
- iv. Duket se subjekti i rivlerësimit ka pasur një mungesë të burimeve të ligjshme financiare në vitin 2012, për të realizuar kursimet *cash* prej 6,500 euro në fund të vitit 2012, në masën -908,180 lekë.
- v. Nga analiza financiare duket se subjekti i rivlerësimit ka pasur një mungesë të burimeve të ligjshme financiare prej -944,946 lekësh, në vitin 2013, për të përballuar të gjitha shpenzimet, investimet dhe kursimet e realizuara gjatë këtij viti. Si pasojë e sa më sipër, duket se subjekti i rivlerësimit në vijim ka pasur një mungesë të burimeve të ligjshme prej -372,265 lekësh⁶⁵, në vitin 2014, për investimin në bono thesari me vlerë 1,000,000 lekë.

Qëndrimi i subjektit të rivlerësimit

⁶⁵ Pavarësisht mungesës së konstatuar në këtë pasuri, kjo mungesë nuk ndikon rezultatin total të vitit 2014, e cila rezulton në total pozitive si pasojë e konsiderimit në të, të të gjitha të ardhurave të vitit.

106. Pasi është njohur me rezultatet e hetimit administrativ të kryer nga Komisioni, subjekti i rivlerësimit ka paraqitur prapësimet, argumentimet dhe prova të reja, të cilat në mënyrë të përmbledhur po përshkruhen dhe analizohen në vijim.
107. Lidhur me konstatimet e Komisionit se: “[...] *Duket se subjekti i rivlerësimit ka pasur një mungesë të burimeve të ligjshme financiare prej -259,770 lekësh, për të mundësuar depozitimën e shumës prej 19,500 euro në dhjetor të vitit 2012, të cilat më pas janë përdorur për të çelur një tjetër depozitë në shumën 20,000 euro, në janar të vitit 2013*”; si dhe “[...] *Duket se subjekti i rivlerësimit ka pasur një mungesë të burimeve të ligjshme financiare në vitin 2012, për të realizuar kursimet cash prej 6,500 euro në fund të vitit 2012, në masën – 908,180 lekë [...]*”.
- I.** Sa i përket mungesave të konstatuara në vitin 2012, subjekti i rivlerësimit në prapësimet ka shpjeguar se: “[...] *Konsiderimi dhe analiza juaj nuk është e saktë për sa sjaruam:*
- Po të analizohen me kujdes deklaratat e viteve 2011 dhe 2012 do të konstatojë se në DIPP-në e vitit 2011 e kemi marrë të mirëqenë dhe kemi deklaruar si pjesë e transaksionit të vitit 2011, depozitën e kursimit 10,000 euro, që është thjesht kalim nga llogaria likuiduese në llogarinë e depozitës së kursimit. Pra, është transaksion që nuk ka të bëjë fare me gjendjen cash, që nuk ka prekur fare gjendjen cash në shtëpi të deklaruar për 3,000,000.*
 - Dividendi marrë nga bashkëshorti në vitin 2011 dhe i kaluar në llogarinë e veçantë të dividendit ka qenë 31,507 euro. Nga shuma totale e dividendit janë tërhequr nga banka 20,000 euro, ndërkohë që diferenca 11,507 ngeli gjendje në bankë deri në fund të vitit.*
 - Në dhjetor të vitit 2011 bashkëshorti vendosi që nga gjendja në bankë në llogarinë e dividendit prej 11,507 euro, të krijonte një depozitë kursimi për 10,000 euro, në emër të tij dhe të vajzës sonë. Kërkesa për transaksionin është bërë në fund të muajit dhjetor 2011, ndërkohë që banka e ka kaluar me datë valute më 4 janar 2012.*
 - Nisur nga ky fakt, pra që depozita nëpërmjet xhirit nga llogaria në llogari u kërkua në vitin 2011, në mënyrë fare transparente në deklaratën e vitit 2011 është evidentuar ky fakt [...]*”.
108. Gjithashtu, subjekti ka shpjeguar se ky veprim i kalimit të shumës prej 10,000 euro nga llogaria rrjedhëse e bashkëshortit në depozitë me afat, është konsideruar e vendosur brenda datës 31.12.2011 dhe është pasqyruar prej tyre në deklarinë e bërë në DIPP-në e vitit 2011 dhe, për rrjedhojë, nuk duhet të ndikojë në gjendjen *cash* të deklaruar të vitit 2011, ku përfshihen vetëm shtesat në likuiditetet që ndodheshin në llogarinë bankare të specifikuar dhe *cash* në banesë dhe jo edhe depozitat.
109. Lidhur me dy konstatimet e para të vitit 2012, subjekti ka dhënë shpjegimet e saj, si dhe ka paraqitur në cilësinë e provës një përgjigje (pa numër protokoll dhe pa datë), të lëshuar nga BKT-ja, në të cilën kanë konfirmuar se në bazë të kërkesës së bërë nga bashkëshorti i subjektit në datën 30.12.2011, është bërë transferimi i shumës prej 10,000 euro nga llogaria e tij në llogarinë e përbashkët me vajzën W. L., për t’u kaluar në depozitë me afat. Kontrata e depozitës është regjistruar në sistem me datë-valutë 4.1.2012.
110. Subjekti, në sqarimet shtesë të dërguara më 1.3.2021, ka pretenduar gjithashtu, neutralizimin e efekteve të kursit të këmbimit në veprimet e saj apo të bashkëshortit me llogaritë bankare/depozitat, duke kërkuar që të shtohen edhe të ardhurat në të njëjtën vlerë.

Vlerësimi i trupit gjykues

111. Trupi gjykues, pasi ka analizuar shpjegimet dhe provat e reja, të paraqitura nga subjekti i rivlerësimit, në kontekstin e mënyrës së deklarimit dhe përshkrimit të gjendjeve *cash*, në raport dhe në përputhje me deklarimet vjetore dhe në harmoni të provave, vlerëson se realisht shuma prej 10,000 euro nuk duhet të konsiderohet si një investim i fillimvitit 2012, – siç ishte përlogaritur më herët – por duhet të pranohen shpjegimet e subjektit se ai investim është realizuar në fund të vitit 2011, sikurse edhe është deklaruar, dhe nuk mund të konsiderohej dhe deklarohet si gjendje *cash* në banesë, për sa kohë ishte paraqitur kërkesa e çeljes së depozitës në fjalë (prej 10,000 euro), ndonëse ajo formalisht ka rezultuar e hapur nga banka në ditët e para të vitit 2012, për shkak të procedurave dhe dinamikave të brendshme të bankës, që ishin të pavarura nga vullneti dhe veprimtaria e subjektit të rivlerësimit apo bashkëshortit të saj. Ky qëndrim bazohet në provat e paraqitura nga subjekti lidhur me kërkesën e çeljes së depozitës në fjalë në fund të vitit 2011, fakt ky i konfirmuar edhe nga një vërtetim/deklaratë e bankës, e cila pohon se për shkak të procedurave të saj, depozita rezultoi e hapur në fillim të janarit të vitit 2012.
112. Nisur nga sa më lart dhe duke mbajtur në vëmendje të njëjtën logjikë deklarimi/veprimi të subjektit, mbi konsiderimin e tepricave të mjeteve monetare të deklaruara si gjendje *cash* dhe gjendje në llogaritë bankare të të ardhurave të subjektit dhe të bashkëshortit, sipas logjikës së subjektit, trupi gjykues vlerëson se rezultoi bindës shpjegimi i subjektit, sipas të cilit shuma e sipërpërmendur, prej 10,000 euro, për sa kohë nuk ka qenë gjendje e mbetur në llogaritë e tyre të pagave dhe dividendëve dhe as si *cash* në banesë, pasi ajo, që nga momenti i paraqitjes së kërkesës pranë bankës përkatëse për çelje depozite, është konsideruar si e dalë provizorisht nga disponibiliteti *de facto* dhe, kësajherë, nuk mund të përfshihej në deklarimin e gjendjes *cash* realisht të disponuar në datën 31.12.2011.
113. Gjithashtu, në mbështetje të arsyetimit të mësipërm, evidentohet se pikërisht në DIPP-në e vitit 2011, subjekti e ka deklaruar si të kryer po në vitin 2011 çeljen e depozitës me shumën 10,000 euro në BKT, me burim nga kursimet (ndonëse e formalizuar në datën 4.1.2012), si dhe ka deklaruar gjithashtu, kursime/tepricë të mjeteve monetare nga të ardhurat familjare të vitit 2011, në shumën prej 3,000,000 lekësh. Kështu që edhe këto elemente plotësojnë dhe mbështesin vlerësimin e mësipërm, e po ashtu edhe logjikën e subjektit mbi moskonsiderimin (mospërfshirjen) e kësaj shume prej 10,000 euro në tepricën e mjeteve monetare të vitit 2011.
114. Nisur nga sa është argumentuar më sipër, në funksion të analizës financiare të Komisionit, gjendja në llogarinë e dividendëve të bashkëshortit, pasi të zbritet depozita prej 10,000 euro, mbetet vetëm shuma prej 1,507 euro (në vend të 11,507 euro që ishte përlogaritur deri në fazën e mbylljes së hetimit administrativ). Për rrjedhojë të këtij rezultati të rishikuar, si dhe për pasojë të efektit “të vazove komunikuese”, për sa kohë deklarimi i subjektit i ka përfshirë të dy zërat⁶⁶ së bashku, gjendja e disponuar *cash* në banesë tashmë rezultoi në total 3,785,041 lekë (në vend të shumës 2,402,041 lekë të konsideruar në rezultatet e dërguara subjektit). Nga kjo shumë rezultoi se mund të përballoheshin investimet e bashkëshortit të subjektit në depozita bankare (shuma prej 10,000 USD investuar më 25.5.2012) dhe depozitim *cash* të kryer në dhjetor të vitit 2012 të shumës prej 19,500 euro (ose ekuivalenti prej 2,724,540 lekësh), me burime të ligjshme financiare nga kursimet e kaluara. Po ashtu, me të ardhurat e vitit 2012 rezultoi se mund të disponoheshin kursimet

⁶⁶ Siç është specifikuar edhe më sipër, vlera e deklaruar në DIPP-në e vitit 2011 nga subjekti si kursime në gjendjen *cash*, përmban/përfshin shtesën e gjendjes likuiditet në llogari bankare së bashku me shtesën e gjendjes *cash* në banesë përgjatë vitit të deklarimit. Për rrjedhojë, duke u nisur nga një shifër totale/akumulative fikse (sa është deklaruar nga subjekti), çdo pakësim i njërit nga këta dy zëra, do të passillte rritjen automatike të tjetrit dhe anasjelltas.

e pretenduara prej 6,500 euro, në fund të vitit, për 908,180 lekë, me burime të ligjshme financiare.

115. Trupi gjykues vlerëson, gjithashtu, se pretendimi i subjektit për neutralizimin e efektit të kursit të këmbimit, në depozitat e saj apo personave të lidhur, në monedha të huaja, duhet të pranohet, ndonëse në këtë rast, nga ripërlllogaritjet e shumave në fjalë – për shkak të zhvlerësimit ndërkohë të monedhës “dollar amerikan” dhe të vlerësimit të monedhës euro, – ka rezultuar se efekti final pas risaktësimit të vlerave të këmbimit ka konsistuar në një “shpenzim” të shtuar dhe jo përfitimi i ndonjë të ardhure shtesë.
116. Për rrjedhojë, në vijim dhe për efekt të sa më sipër, situata financiare e vitit 2012 për familjen e subjektit të rivlerësimit, në përfundim të këtij procesi, ka rezultuar me bilanc pozitiv (siç është detajuar në tabelën e mëposhtme), pasi të dyja rezultatet e njoftuara lidhur me këtë pikë pësojnë ndryshime, të cilat çojnë në konkluzionin e mjaftueshmërisë së burimeve të ligjshme financiare për të gjitha investimet dhe shpenzimet e kryera apo kursimet e deklaruara për vitin në fjalë⁶⁷.

Tabela nr. 9 - Ripërlllogaritja e të ardhurave të përdorura në vitin 2012

	Ne rezultate	Pas prapesimeve
Te ardhurat e vitit 2012	5 547 071	5 547 071
Likuiditetet ne banke ne fillim te vitit 2012	4 373 681	4 373 681
Likuiditetet ne banke ne fund te vitit 2012	(11 368 689)	(11 352 347)
Pakesimi i gjendjes cash	1 493 861	2 876 861
Shpenzime te vitit 2012	(1 244 866)	(1 244 866)
Rezultati i vitit 2012	(1 198 942)	200 400

117. Lidhur me konstatimin e Komisionit se: *Nga analiza financiare duket se subjekti i rivlerësimit ka pasur një mungesë të burimeve të ligjshme financiare prej -944,946 lekësh, në vitin 2013, për të përballuar të gjitha shpenzimet, investimet dhe kursimet e realizuara gjatë këtij viti. Si pasojë e sa më sipër, duket se subjekti i rivlerësimit në vijim ka pasur një mungesë të burimeve të ligjshme prej -372,265 lekësh, në vitin 2014, për investimin në bono thesari me vlerë 1,000,000 lekë”.*

Qëndrimi i subjektit të rivlerësimit

Sa i përket mungesës së konstatuar në vitin 2013, subjekti ka pretenduar se gjendja e disponuar *cash* në banesë në fund të vitit 2013, ka qenë në total 8,000 euro, duke dhënë shpjegimet se: “[...] Në DPV-në e vitit 2013 unë kam deklaruar tepërisht në mjete monetare nga të ardhurat e vitit 2013, shumën 300,000 lekë, e cila së bashku me kursimet e akumuluar të vitit 2012 (6,500 euro) bëjnë afërsisht 8,000 euro të deklaruara në rubrikën “të ardhurat dhe angazhimet në veprimtari publike/private” të bashkëshortit, ku deklarojmë ‘gjendje cash me të ardhurat nga vitet e kaluara shuma 8,000 euro’. Pra, kjo shumë 8,000 euro është gjendja cash në fund të 2013 [...]”.

118. Subjekti ka pretenduar gjithashtu:

⁶⁷ Në të cilën është përfshirë dhe neutralizimi i efektit të kursit të këmbimit, duke vazhduar depozitat të përlllogariten me kursin e tyre fillestar, çka për vitin 2012 ka sjellë uljen e gjendjes së likuiditeteve në sistemin bankar, në fund të vitit 2012, siç është paraqitur dhe në tabelë.

- i. uljen e shpenzimeve të udhëtimeve të konstatuara sipas sistemit *TIMS*, sa i përket udhëtimeve të familjes për në Selanik, Greqi, në të cilat subjekti ka deklaruar se ka qëndruar te shtëpia e kumatës (motrës së bashkëshortit);
 - ii. të përfshihen në analizën financiare të ardhurat e bashkëshortit nga botimi i librit “tatimet dhe administrimi tatimor” në shumën 83,200 lekë (këto të ardhura janë deklaruar në DIPP-në e vitit 2013, por nuk kanë qenë të dokumentuara deri në mbylljen e hetimit administrativ);
 - iii. të përfshihen në analizën financiare të ardhurat nga interesat bankare dhe të konsiderohen sipas deklaramit të bashkëshortit në DIPP-në e vitit 2013, në shumën prej 199,604 lekësh.
119. Gjithashtu, subjekti ka shpjeguar se për investimin në bono thesari në vitin 2014, duke konsideruar me burime të ligjshme të gjithë gjendjen *cash* në fund të vitit 2013, ka deklaruar se ka pasur mundësi për investimin me burime të ligjshme financiare duke shtuar se, meqenëse bashkëshorti ka qenë ortak i vetëm te shoqëria “K.” sh.p.k., ka pasur akses në arkën e shoqërisë, por duke qenë se nuk ka shpërndarë dividendë, ato nuk janë deklaruar si të ardhura në vitin 2013.
120. Subjekti, në mbështetje të sa më lart është pretenduar prej tij, ka paraqitur në cilësinë e provës një deklaratë të datës 19.2.2021, të lëshuar nga kunati, shtetasi Stylianos Pargianas, në gjuhën greke, të përkthyer në gjuhën shqipe dhe të noterizuar, në të cilën ka deklaruar se gjatë periudhës 1996 – 2020, së bashku me bashkëshorten L. L., kanë mbuluar shpenzimet për strehim dhe ushqim për familjen e subjektit, gjatë udhëtimeve të tyre me destinacion Selanikun. Po ashtu, ka paraqitur vërtetimin mbi certifikatën familjare të shtetasit S. P., në gjuhën greke, përkthyer në gjuhën shqipe dhe noterizuar, i cili rezultoi i martuar me shtetasen L. L. (motra e bashkëshortit të subjektit) prej vitit 1996.
121. Gjithashtu, lidhur me të ardhurat e bashkëshortit nga botimi i librit, subjekti ka paraqitur në cilësinë e provës vërtetimin nr. *** prot., datë 19.2.2021, të lëshuar nga A. University, nëpërmjet të cilit konfirmohet se në vitin 2013 bashkëshorti i subjektit ka përfutur të ardhura *neto* nga botimi i librit në shumën 83,200 lekë. Po ashtu është paraqitur në cilësinë e provës një mandatpagesë në shumën 100,000 lekë, tërheqje nga pronari, në datën 7.1.2014. Për të provuar sa më sipër, subjekti ka paraqitur edhe lëvizjet e arkës së vitit 2014, në të cilën është pasqyruar edhe veprimi i sipërpërmendur.

Vlerësimi i trupit gjykues

122. Trupi gjykues, pasi ka analizuar shpjegimet e subjektit dhe dokumentacion mbështetës të paraqitur pas njohjes me rezultatet e hetimit, ka vlerësuar çdo pretendim duke e pranuar ose jo sipas rastit dhe nivelit të provueshmërisë dhe besueshmërisë së tyre, dhe konkretisht:
- a. Lidhur me pretendimet e subjektit për vitin 2013, nga Komisioni janë zbritur shpenzimet e udhëtimeve me destinacion në Selanik, Greqi, për vitet 2010, 2011, 2013 dhe 2014. Këto udhëtime ishin deklaruar edhe në përgjigjet e subjektit në pyetësorin nr. 1, duke e specifikuar qëndrimin tek të afërmit e tyre atje, por deri në momentin e mbylljes së hetimit nuk ishte paraqitur ndonjë dokumentacion ligjor provues. Pasi dokumentacioni në fjalë është paraqitur, trupi gjykues i ka konsideruar bindëse shpjegimet e subjektit dhe, për rrjedhojë, nuk i ka konsideruar shpenzimet e udhëtimeve në fjalë në masën e përlllogaritur më herët, por vetëm në shumën minimale prej 5 euro në ditë të qëndrimit jashtë shtetit – sipas qëndrimit të Kolegjit të Posaçëm të Apelit.

- b. Po ashtu, pas paraqitjes së prapësimeve nga subjekti, janë përfshirë në analizën financiare të ardhurat e përfituara nga botimi i librit “Tatimet dhe administrimi tatimor” prej 83,200 lekësh – sipas vërtetimit të lëshuar nga universiteti, në të cilin konfirmohet se bashkëshorti i subjektit ka përfituar shumën *neto* në fjalë, nga ky burim të ardhurash. Në konfirmim dhe mbështetje të këtij fitimi është përdorur edhe një mandatpagese i datës 15.4.2013, i lëshuar nga U. (A. University sot) dhe i bashkëngjitur me deklaratën *Vetting*, nga ku rezultonte se është paguar në favor të shtetasit N. L. shuma prej 83,200 lekësh për 130 libra, por, deri në mbylljen e hetimit administrativ të Komisionit nuk ishte qartësuar aspekti i pagesës së tatimit – pra, nëse kjo e ardhur ishte apo jo *neto* dhe e ligjshme nën këndvështrimin e dispozitave përkatëse (neni D i Aneksit të Kushtetutës), pasi kjo rrethanë u qartësua nëpërmjet prapësimeve dhe dokumentit të sipërpërmendur, Komisioni i mori në konsideratë dhe i përfshiu në analizën financiare përkatëse këto të ardhura.
- c. Gjithashtu, është pranuar pretendimi i subjektit për sa i përket të ardhurave nga interesat bankare dhe, për rrjedhojë, janë rillogaritur interesat e depozitave të bashkëshortit në “Alpha Bank”, BKT dhe “Raiffeisen Bank”, të cilat kanë rezultuar në masën totale 128,620 lekë (përfshirë edhe interesat e përfituara nga llogaria rrjedhëse) nga 199,604 lekë të pretenduara nga subjekti.
- d. Ndërkohë që, nga ana tjetër, trupi gjykues nuk e pranoi, pasi e konsideroi të pabazuar pretendimin e subjektit lidhur me përfshirjen si disponibilitet financiar të shumës 300,000 lekë (të deklaruar nga subjekti në DIPP-në e vitit 2013 si tepricë të mjeteve monetare me të ardhurat e vitit 2013), si pjesë e gjendjes monetare të deklaruar nga bashkëshorti i saj, të shumës prej 8,000 euro (të deklaruar në DIPP nga kursimet e viteve të kaluara). Në këto kushte dhe në këtë pikë, trupi gjykues vlerëson se ky pretendim nuk plotëson kushtet kumulative të deklarimit të gjendjes *cash* si shtesë që rrjedh nga kursimet e vitit përkatës dhe burimin e ligjshëm të krijimit të të ardhurave në fjalë, për rrjedhojë sipas standardit të konsoliduar tashmë, kjo shumë nuk mund të përshihet në analizën financiare si një e ardhur e realizuar dhe e kursyer në vitin 2013.
123. Në vijim dhe për efekt të ndryshimeve të mësipërme, rezultati final i bilancit të vitit 2013 kalon nga vlera -944,946 (në një diferencë gjithmonë negative) në vlerën -743,616 lekë⁶⁸, siç është pasqyruar në mënyrë të detajuar në tabelën vijuese.

Tabela nr. 10 - Ripërlllogaritja e të ardhurave të përdorura në vitin 2013

	Ne rezultate	Pas prapesimeve
Te ardhurat e vitit 2013	1 971 523	2 058 011
Gjendja ne banke ne fillim te vitit 2013	11 368 689	11 352 347
Gjendja ne banke ne fund te vitit 2013	(12 345 666)	(12 347 146)
Shpenzime te vitit 2013	(1 198 373)	(1 065 709)
Shpenzime per pagesen e kredise	(227 619)	(227 619)
Rritja e gjendjes cash nga 2012 ne 2013	(513 500)	(513 500)
Rezultati i vitit 2013	(944 946)	(743 616)

124. Nisur nga përfundimi i mësipërm, ka rezultuar se në fund të vitit 2013 kursimet e disponuara në banesë nga subjekti, me burime të ligjshme financiare, mund të ishin

⁶⁸ Në këtë rezultat është përfshirë edhe neutralizimi i efektit të kursit të këmbimit të depozitave në valutë të bashkëshortit të subjektit, si pasojë e vlerësimit të monedhës euro dhe zhvlerësimit të monedhës USD.

maksimalisht në vlerën 678,064 lekë (dhe jo 476,734 lekë, sa kishte rezultuar nga hetimi administrativ) – shumë e cila mund të përdorej për investimin në bono thesari në vitin 2014, dhe, për rrjedhojë, për shkak të këtij investimi, ndonëse bilanci i përgjithshëm i vitit 2014 rezulton pozitiv, nga ripërlllogaritja e burimeve për investimin në bono thesari në vitin 2014, ka rezultuar një mungesë financiare në vlerën -170,934⁶⁹ lekë (dhe jo në vlerën -372,265 lekë, që ishte njoftuar me rezultatet e hetimit), siç është detajuar në tabelën vijuese.

Tabela nr. 11 - Ripërlllogaritja e të ardhurave të përdorura për investimin në bono thesari, në vitin 2014

	Ne rezultate	Pas prapësimeve
Terheqje nga llogarite deri 28.03.2014	354 000	354 000
Depozitimi shumes 1,000,000 Leke	(1 000 000)	(1 000 000)
Likuiditete (cash) ne fund 2013	476 734	678 064
Shpenzime jetese/kredie janar-mars 2014	(202 999)	(202 999)
Rezultati	(372 265)	(170 934)

125. Gjithashtu, lidhur me vitin 2014, subjekti ka pretenduar konsiderimin e një disponibiliteti financiar dhe, konkretisht, të shumës 100,000 lekë që, sipas shpjegimeve të fundit të tij, ato ishin tërhequr nga bashkëshorti nga arka e shoqërisë “K.” sh.p.k., në janar të vitit 2014. Trupi gjykues vlerëson se ky burim nuk është deklaruar më herët nga subjekti as në DIPP-në e vitit dhe as në deklaratën *Vetting*, por përmendet për herë të parë pas njohjes me rezultatet e hetimit, nëpërmjet prapësimeve. Gjithashtu, për sa kohë as nuk ka rezultuar plotësisht e provuar sa është pretenduar, këto të fundit ngelin në nivel deklarativ dhe, për rrjedhojë, shuma në fjalë nuk mund të përfshihet si një e ardhur e disponueshme në këtë vit.
126. Në konkluzion dhe për efekt të sa është argumentuar më sipër lidhur me pretendimet e subjektit, si dhe mbi pranimin apo moskonsiderimin si të bazuara të tyre, dhe pas rishikimit të analizës financiare të kryer nga Njësia e Shërbimit Ligjor të Komisionit, ka rezultuar një situatë e përgjithshme financiare e periudhës së rivlerësimit, 2003 – 2016, me një mungesë financiare në vlerën -743,616 lekë, siç është pasqyruar në mënyrë të detajuar në tabelën e paraqitur në paragrafin e analizës financiare.

10. Obligacione qeveritare në shumën 2,000,000 lekë, të investuar në datën 16.7.2015

127. Investimi në obligacionet qeveritare të cituara më sipër është deklaruar për herë të parë në DIPP-në e vitit 2015 prej bashkëshortit të subjektit të rivlerësimit me burim fondet e dy depozitave të mbyllura në “Alpha Bank” në korrik të vitit 2015. Nga lëvizjet bankare është konfirmuar se shuma prej 2,000,000 lekësh, e investuar në obligacione, është transferuar nga llogaria e bashkëshortit të subjektit të rivlerësimit në “Alpha Bank”, te llogaria e tij në “Intesa Sanpaolo Bank”. Konkretisht, z. N. L. ka mbyllur përpara afatit dy depozitat me afat në “Alpha Bank” dhe ka kryer transfertat përkatësisht të shumave 1,171,000 lekë, në datën 29.6.2015 dhe 742,000 lekë, në datën 7.7.2015. Depozitat në “Alpha Bank” janë çelur përkatësisht në shumat 500,000 lekë në vitin 2007⁷⁰ dhe 1,000,000 lekë më 23.12.2010 e, më pas, janë shtuar me interesat përkatëse ndër vite.

⁶⁹ Edhe në këtë rezultat, sërish është përfshirë edhe neutralizimi i efektit të kursit të këmbimit të depozitave në valutë të bashkëshortit të subjektit, si pasojë e vlerësimit të monedhës euro dhe zhvlerësimit të monedhës USD.

⁷⁰ Çelja e depozitës prej në shumën 500,000 lekë në vitin 2007 është bazuar në deklarinimin e subjektit të rivlerësimit në DIPP-në e vitit 2007, pasi bazuar në shkresën nr. *** prot., datë 19.12.2019 nga “Alpha Bank”, kjo bankë ka vënë në dispozicion informacionin dhe dokumentacionin nga data 2.3.2009 e në vijim, pasi ndryshimi i sistemit informatik të bankës ka bërë që platformat e mëparshme të jenë të paaksesueshme.

128. Në DIPP-në e vitit 2007, subjekti i rivlerësimit ka deklaruar çeljen e depozitës në shumën 500,000 lekë nga bashkëshorti, me burim nga gjendja *cash* e trashëguar nga viti 2006, e cila ka qenë në vlerën 1,000,000 lekë, çka duket se mjaftojnë për investimin e kësaj shume në depozitë në vitin 2007. Në DIPP-në e vitit 2010, subjekti nuk ka deklaruar burimin e krijimit të depozitës në shumën 1,000,000 lekë.
129. Komisioni, nga analizimi i llogarive bankare, konstatoi se subjekti dhe bashkëshorti kanë tërhequr nga llogaritë e tyre bankare me burime të ligjshme, shumat 859,900 lekë dhe 20,000 euro, çka duket se mjaftojnë për kryerjen e investimit prej 1,000,000 lekësh në fund të vitit 2010.
130. Për rrjedhojë, nga sa më sipër dhe nga analiza financiare e kryer nga Njësia e Shërbimit Ligjor të Komisionit, ka rezultuar se subjekti i rivlerësimit ka pasur mundësi në vitet 2006 dhe 2010, për krijimin me burime të ligjshme financiare të depozitave përkatësisht me vlerë 500,000 lekë dhe 1,000,000 lekë dhe të përdorura më pas për investimin në obligacionet e analizuara në këtë pikë.

11. Gjendje në llogarinë rrjedhëse në shumën 371,555 lekë, në “Credins Bank”, në emër të subjektit të rivlerësimit

129. Nga verifikimi i llogarive bankare është konstatuar se konfirmohet gjendja e llogarisë së pagës së subjektit të rivlerësimit në shumën 371,555 lekë, e cila përputhet me deklarin e subjektit në deklaratën *Vetting*. Po ashtu, konfirmohet krijimi i kësaj gjendjeje me të ardhurat nga pagat. Për rrjedhojë, nuk kanë rezultuar problematika lidhur me këtë gjendje llogarie.

12. Gjendje në llogaritë rrjedhëse në “Intesa Sanpaolo Bank” në shumat 84,493 lekë dhe 765 euro, si dhe në BKT, në shumat 445 lekë dhe 33,935 euro

130. Nga verifikimi i llogarive bankare është konstatuar se konfirmohen gjendjet e llogarive të bashkëshortit të subjektit në BKT në shumat 445 lekë dhe 33,935 euro. Po ashtu, konfirmohet burimi i krijimit të këtyre gjendjeve, që rrjedh nga dividendët e shpërndarë nga shoqëria “K.” sh.p.k. dhe pagat e përfituara nga bashkëshorti pranë kësaj shoqërie.
131. Nga verifikimi i llogarive bankare është konstatuar se konfirmohen gjendjet e llogarive të bashkëshortit në “Intesa Sanpaolo Bank” në shumat përkatësisht 84,493 lekë (shuma totale e dy llogarive të bashkëshortit në këtë bankë prej 78,500 lekësh dhe 5,993 lekësh) dhe 765 euro. Po ashtu, konfirmohet burimi i krijimit të këtyre gjendjeve përkatësisht nga të ardhurat e bashkëshortit nga kontrata e konsulencës me I.-në⁷¹, datë 11.6.2014⁷², nga interesat e obligacioneve të investuara nga bashkëshorti⁷³ dhe nga transfertat e kryera nga Fondi Shqiptar i Garancisë për pjesëmarrjen në bordin teknik të fondit⁷⁴.
132. Nisur nga sa më sipër, nuk janë konstatuar problematika lidhur me gjendjet e disponuara në llogaritë bankare të subjektit dhe bashkëshortit, për sa kohë janë deklaruar saktësisht dhe janë krijuar me burime të ligjshme financiare.

⁷¹ I. F. C..

⁷² Transferuar në datën 30.9.2014 pagesa totale e kontratës prej 525,000 lekësh. Referuar kësaj kontrate, bashkëshorti do të paguhej në masën 21,000 lekë /dita, *neto* pas taksave.

⁷³ Përfituar interes në datat 22.1.2016 dhe 22.7.2016 nga 46,500 lekë secila, nga të cilat është mbajtur tatimi prej 15%.

⁷⁴ Kaluar pagesa nga Fondi i Garancisë Shqiptare në shumat 255 euro secila në datat 12.6.2015, 22.10.2015 dhe 19.2.2016. Lidhur me këto pagesa, nisur nga fakti që transfertat janë kryer nga institucioni nëpërmjet bankës në llogari të bashkëshortit, që institucioni në fjalë është një program italo-shqiptar për zhvillimin e ndërmarrjeve të vogla dhe të mesme në Shqipëri i krijuar në bashkëpunim me Ministrinë e Financave dhe agjencisë italiane për bashkëpunim dhe zhvillim, për të cilin pagesat tatimore të anëtarëve të bordit duhet të jenë kryer së bashku me gjithë pagesat e detyrimeve të tjera tatimore, si dhe faktin që këto shuma të përfituara nuk ndikojnë në analizën financiare të viteve përkatëse 2015 dhe 2016, nga Komisioni nuk shikohet i nevojshëm hetimi i mëtejshëm mbi ligjshmërinë e këtyre të ardhurave.

13. Gjendje *cash* 500,000 lekë

133. Nga hetimi administrativ i kryer nga Komisioni ka rezultuar se në deklaratën *Vetting*, bashkëshorti i subjektit ka deklaruar disponimin e një gjendjeje monetare *cash* në shumën 500,000 lekë. Ndërkohë që edhe në DIPP-në e vitit 2014, subjekti ka deklaruar gjendje *cash* në shumën 500,000 lekë dhe, më pas, në DIPP-në e vitit 2015 subjekti ka deklaruar gjendjen *cash* në shumën 550,000 lekë dhe në DIPP-në e vitit 2016 ka deklaruar pakësimin e kësaj gjendjeje me vlerën 50,000 lekë⁷⁵. Kjo dinamikë ndryshimesh përkon me deklarin e kryer në deklaratën *Vetting*, lidhur me gjendjen *cash* të disponuar në shumën 500,000 lekë.
134. Komisioni ka analizuar mundësinë e kursimit të kësaj shume me burime të ligjshme, fillimisht në vitin 2014. Në këtë vit ka rezultuar se përgjatë periudhës prill⁷⁶ – dhjetor, subjekti ka tërhequr nga llogaria e pagës në “Credins Bank”, shumën 967,000 lekë, ndërsa bashkëshorti nga llogaria në BKT ka tërhequr shumën 4,100 euro dhe nga llogaria në “ProCredit Bank” shumën 489,000 lekë.
135. Pas konsiderimit të të gjitha shpenzimeve të kryera përgjatë të njëjtës periudhë, të cilat shkonin totalisht në shumën 1,492,312 lekë⁷⁷, ka rezultuar se subjekti dhe bashkëshorti kishin burime financiare të ligjshme me të cilat mund të dispononin kursimet *cash* në shumën 500,000 lekë, në fund të vitit 2014 – siç është pasqyruar edhe në tabelën vijuese. Rrjedhimisht, rezulton i provuar edhe burimi i ligjshëm i së njëjtës gjendje *cash* të deklaruar më pas edhe në deklaratën *Vetting*.

Tabela nr. 12 - Mundësia e realizimit të kursimit *cash* në vitin 2014

Terheqje nga llogarite deri 01.04.2014-31.12.2014	2 030 451
Shuma te derdhura per pagesen e kredise RZB	(190 000)
Kursime ne fund te vitit cash	(500 000)
Shpenzime te vitit (udhetime/mjekesore/arsimi)	(807 316)
Shpenzime jetese prill-dhjetor 2014	(494 996)
Rezultati	38 139

REZULTATET PËRFUNDIMTARE TË ANALIZËS FINANCIARE

136. Në vijim të analizës financiare të kryer mbi deklarinmet periodike, ndër vite, pas përlllogaritjeve të kryera në mënyrë të detajuar sipas viteve, në Aneksin 1 që i bashkëngjitet këtij dokumenti, janë paraqitur të gjitha të dhënat mbi të ardhurat, shpenzimet, kursimet,

⁷⁵ Deklarohet: “në fillim të vitit ishte 550,000 lekë, në fund të vitit 500,000 lekë”.

⁷⁶ Konsideruar në këtë analizë, periudha pas investimit të shumës prej 1,000,000 lekësh në bono thesari, e cila është trajtuar më lart.

⁷⁷ Në të cilën përfshihen shpenzimet e jetesës, shpenzimet e shkollimit të vajzës, shpenzimet mjekësore të vajzës dhe shpenzimet e pagesës së kredisë në “Raiffeisen Bank”.

detyrimet dhe nga përlllogaritja krahasimore e tyre është vlerësuar dhe konkluduar mbi mjaftueshmërinë ose jo të burimeve financiare, për çdo vit, për të përballuar investimet, shpenzimet apo kursimet e deklaruar dhe/ose të konstatuara, me të ardhura nga burime të ligjshme, në kuptimin e nenit D të Aneksit të Kushtetutës.

137. Në analizën e paraqitur subjektit, pas mbylljes së hetimit administrativ, ishin konsideruar dhe përpunuar të dhënat e disponuara deri atë moment, duke filluar nga viti 2003, vit në të cilin fillon edhe deklarimi i pasurisë nga subjekti në ILDKPKI, nga ku, në fazën e hetimit administrativ kishte rezultuar një bilanc i përgjithshëm negativ në vlerën -2,143,888 lekë.
138. Pasi janë analizuar pretendimet e subjektit dhe janë analizuar dokumentet e paraqitura prej tij pas njohjes së rezultateve të hetimit, trupi gjykues ka vlerësuar dhe çmuar se disa të ardhura që duhet të përfshiheshin në analizën financiare, si dhe të zbriteshin disa shpenzime, për sa kohë shkaqet e këtyre ndryshimeve më herët nuk ishin të njohura nga Komisioni⁷⁸. Si përfundim, pasi janë përfshirë edhe rishikimet e kryera nga Njësia e Shërbimit Ligjor të Komisionit në analizën financiare, nisur nga pranimi i disa prej pretendimeve të paraqitura nga subjekti i rivlerësimit bashkë me disa dokumente provuese, nëpërmjet prapësimeve – siç janë analizuar, vlerësuar dhe arsyetuar në paragrafët specifike, lidhur me pasuritë dhe burimet financiare konkrete të viteve përkatëse – ka rezultuar një situatë e përgjithshme financiare lidhur me periudhën e rivlerësimit, 2003 – 2016, me një mungesë financiare në vlerën -743,616 lekësh, siç është pasqyruar në mënyrë të detajuar në tabelën vijuese.

	2003	2004	2005	2006	2007	2008	2009	2010	2011	2012	2013	2014	2015	2016
PASURI	476,000	1,786,996	1,554,435	565,021	1,129,152	-770,622	1,135,053	2,559,562	4,117,101	4,101,805	1,508,299	1,061,932	615,267	-225,586
Apartament banini Tirane 130 m2 (me b/sh)			2,007,780											
Apartament ne K. 55 m2														
Automjet Spark nga A*** Sh.p.k						500,000								
Automjet Citroen C3								1,610,196						
Token are ne V. 345 m2 (prone e Bsh)	276,000													
Shtepi private 100 m2 ne Korce (prone e Bsh)														
Ndrysishim likuiditeti	200,000	1,786,996	-453,345	565,021	1,129,152	-1,270,622	1,135,053	949,366	4,117,101	4,101,805	1,508,299	1,061,932	615,267	-225,586
TOTAL LIKUIDITETE DEKLARUAR	200,000	1,986,996	1,533,651	2,098,671	3,227,823	1,957,202	3,092,255	4,041,621	8,158,722	12,260,527	13,768,826	14,830,758	15,446,025	15,220,439
DETYRIME	-227,619	-227,619	871,383	-453,694	-495,464	-1,409,315	-482,204	-446,110	-428,313	-277,911	-227,619	-227,619	-227,619	-227,619
Kredi nga Banka Kursimeve 4,000,000 leke	-227,619	-227,619	-208,651	-246,588	-227,619	-208,651	-246,588	-227,619	-227,619	-227,619	-227,619	-227,619	-227,619	-227,619
Kredi nga Alpha Bank 1,300,000 leke			1,080,034	-207,106	-267,845		-235,616	-218,491	-200,694	-50,292				
Dhene hua nenes se SR E*** R***						-1,000,000								
PASURI NETO	703,619	2,014,615	683,052	1,018,715	1,624,616	638,693	1,617,257	3,005,673	4,545,414	4,379,717	1,735,918	1,289,551	842,886	2,033
TË ARDHURA dokumentuar	2,842,059	2,961,771	2,981,040	3,045,579	3,154,743	2,006,287	3,441,919	6,375,748	7,141,994	5,547,071	2,058,011	3,639,068	4,011,604	2,822,474
Te ardhura SR vertetuar	1,523,749	1,571,348	1,590,315	1,589,379	1,708,600	828,507	1,083,409	994,957	1,118,775	1,205,232	1,098,292	1,298,731	1,349,807	1,315,773
Te ardhura BSH vertetuar	1,318,310	1,390,423	1,390,725	1,456,200	1,446,143	1,177,780	2,358,510	5,380,791	6,023,218	4,341,839	959,720	2,340,338	2,661,797	1,506,701
SHPENZIME	281,592	344,962	418,671	514,226	712,193	974,041	903,508	1,077,261	1,293,191	966,955	1,065,709	1,370,052	1,465,900	1,747,191
Shpenzime jetese	281,592	281,592	328,671	328,671	369,266	409,860	409,860	409,860	409,860	423,072	423,072	659,994	672,828	705,276
Shpenzime per aktivitetin K*** Sh.p.k						50,000					50,000			
Shpenzime shkollore per vajzen					113,900	320,280	341,230	323,750	344,050	346,500	346,500	345,250	528,731	231,905
Shpenzime arretradi			90,000			50,000	100,000	245,000						467,242
Shpenzime udhetime		63,370	0	185,555	229,028	243,901	42,418	243,651	286,281	183,383	241,137	264,808	234,861	328,028
Shpenzime mjekesore W***													100,000	
Shpenzime qiraje														
Shpenzime siguracioni automjeti							10,000		8,000	14,000	5,000		29,480	14,740
Analiza dokumentuar	1,856,848	602,194	1,879,317	1,512,639	817,934	393,552	921,153	2,292,814	1,303,389	200,400	-743,616	979,466	1,702,818	1,073,250
CASH në lekë	200,000	1,000,000	800,000	1,000,000	900,000	300,000	1,178,095	1,100,000	3,785,041	908,180	1,421,680	500,000	550,000	500,000
DIFERENCA E PA MBULUAR		-743,616												

B. KONTROLLI I FIGURËS

139. Drejtoria e Sigurisë së Informacionit të Klasifikuar (DSIK) ka kryer kontrollin e figurës së subjektit të rivlerësimit. Për këtë qëllim, në përputhje me nenin 39 të ligjit nr. 84/2016, është përcjellë në Komision raportit me nr. *** prot., datë 26.10.2017, për subjektin e

⁷⁸ Të ardhura të përfituara përtej pagës bazë nga punësimet, si honorare apo shpërblime.

rivlerësimit, me të cilin është konstatuar përshtatshmëria e subjektit të rivlerësimit, znj. Ledina J. Lera (Riza), për vazhdimin e detyrës.

140. Me shkresën e datës 8.10.2019, nr. *** prot., DSIK-ja i ka bërë me dije Komisionit se raporti i sipërcituar është deklasifikuar plotësisht në datën 4.10.2019, me vendimin nr. ***, të KDZH-së.
141. Në vijim të komunikimeve të mëtejshme me organet ligjzbatuese, përgjatë hetimit administrativ të kryer nga Komisioni, nuk kanë rezultuar informacione apo fakte të reja për këtë subjekt lidhur me kontakte të papërshtatshme apo mbi integritetin personal/profesional, që mund të lidhen me këtë kriter rivlerësimi dhe, për rrjedhojë, Komisioni nuk ka gjetur elemente për të dyshuar mbi konkluzionet e arritura nga DSIK-ja për këtë subjekt dhe, në përfundim, çmon se subjekti i rivlerësimit është i përshtatshëm për vijimin e detyrës.

C. RIVLERËSIMI I AFTËSIVE PROFESIONALE

142. Komisioni ,në bazë të neneve 40-44 të ligjit nr. 84/2016, pasi ka administruar dhe analizuar raportin e KLP-së, si dhe dokumentacionin e bashkëngjitur – ka kryer rivlerësimin e aftësive profesionale të subjektit të rivlerësimit, znj. Ledina Lera, në përputhje me nenin E të Aneksit të Kushtetutës. Rivlerësimi i aftësive profesionale është mbështetur në: (a) raportin për analizimin e aftësisë profesionale të subjektit të rivlerësimit të kryer nga KLP-ja, dërguar me shkresën nr. *** prot., datë 29.5.2020, protokolluar nga Komisioni me nr. ***, datë 29.5.2020; (b) informacionin e marrë nga burime të ligjshme, si i tillë është konsideruar informacioni i marrë; (c) kriteret e vlerësimit të parashikuara në nenin 71 e vijues të ligjit nr. 96/2016, “Për statusin e gjyqtarëve dhe prokurorëve në Republikën e Shqipërisë”.

C/1. Analiza e aftësive profesionale të kryer nga KLP-ja

143. Në raportin e KLP-së janë analizuar të dhënat nga dokumentet, duke iu referuar kriterëve të vlerësimit: aftësi profesionale; aftësi organizative; etika dhe angazhimi ndaj vlerave profesionale dhe aftësitë personale dhe angazhimi profesional. Ky raport është hartuar bazuar në përshkrimin dhe analizimin e: (i) formularit të vetëdeklarimit të tri dokumenteve ligjore të përzgjedhura nga subjekti i rivlerësimit, si dhe të dhënave e dokumenteve të tjera që shoqërojnë formularin e vetëdeklarimit dhe që janë paraqitur nga subjekti i rivlerësimit; (ii) pesë dosjeve penale të përzgjedhura sipas një sistemi objektiv dhe rastësor; (iii) të dhënave nga sektori i burimeve njerëzore në Prokurorinë e Përgjithshme.
144. Vlerësimi i përgjithshëm i kryer nga KLP-ja mbi aftësitë profesionale ka qenë pozitiv për subjektin e rivlerësimit, znj. Ledina Lera. Sipas këtij vlerësimi evidentohet se: subjekti i rivlerësimit, znj. Ledina Lera, shfaq aftësi në arsyetim ligjor, tregon vëmendje që aktet e përgatitura prej saj të paraqiten të strukturuar me një gjuhë të kuptueshme në respektim të rregullave drejtshkimore dhe etike. Sipas të dhënave të deklaruara nga subjekti në formularin e vetëdeklarimit rezulton se për periudhën e punës si prokurore, subjekti ka trajtuar 4442 praktika ekzekutimesh. Nga gjetjet në dokumentet ligjore të përzgjedhura nga shorti, nuk konstatohen vonesa në nxjerrjen e urdhërezekutimeve. Subjekti i rivlerësimit, znj. Ledina Lera (Riza), kryen veprime procedurale që i përkasin kapitullit të ekzekutimeve në Kodin e Procedurës Penale dhe veprimet e kryera prej saj si prokurore rezultojnë të jenë

produktive. Konstatohet që nga subjekti i rivlerësimit veprimet dhe procedurat në kuadër të ekzekutimeve të vendimeve penale, u referohen dispozitave ligjore përkatëse. Lidhur me njoftimet e vendimmarrjeve konstatohet se është respektuar detyrimi për të kryer njoftimet përkatëse subjekteve. Prokurorja ka treguar aftësi shumë të mira në drejtim të rregullsisë së akteve dhe mbajtjes së tyre sipas një rregulli të mirëpërcaktuar në dosjet përkatëse.

145. Dosjet e praktikave të vëzhguara janë shumë të rregullta, të plota dhe aktet procedurale të përpiluara, janë të strukturuar dhe në respektim të normave të drejtshkrimit nga subjekti. Nga praktikat e dosjeve të hedhura në short ka rezultuar se gjuha e përdorur nga subjekti i rivlerësimit në përpilimin e akteve është në përputhje me etikën profesionale të prokurorit. Rezulton se nuk janë gjetur të dhëna që të tregojnë se nga subjekti të jenë kryer veprime apo mbajtur qëndrime të tilla, jo në përputhje me etikën profesionale të prokurorit. Nga të dhënat e deklaruara nga subjekti i rivlerësimit, znj. Ledina Lera (Riza), dhe nga pesë dosjet e vëzhguara konstatohet se nuk kanë dalë të dhëna për ndikime apo çdo formë tjetër presioni të jashtëm ndaj subjektit.
146. Gjithashtu, nga verifikimi në arkivin e Prokurorisë së Përgjithshme rezulton që ndaj subjektit të rivlerësimit nuk është dhënë asnjë masë disiplinore, si dhe vlerësimi për punën në periudhën që i përket viteve 2014, 2015 dhe 2016 ka qenë “shumë mirë”. Në arkivin e Prokurorisë së Përgjithshme janë administruar disa ankesa, në të cilat përmendet subjekti i rivlerësimit të cilat janë marrë në analizë, por në përfundim nuk kanë konstatuar ndonjë shkelje të rëndë të subjektit të rivlerësimit.

C/2. RIVLERËSIMI I AFTËSISË PROFESIONALE NGA KOMISIONI

147. Komisioni, në bazë të neneve 40 - 44 të ligjit nr. 84/2016, pasi ka analizuar raportin e KLP-së, si dhe dokumentacionin e bashkëngjitur, ka kryer rivlerësimin e aftësive profesionale në përputhje me nenin E të Kushtetutës, duke shqyrtuar informacionet e marra nga rrugë alternative.
148. Ka rezultuar se në Komision – bazuar në nenin 53 të ligjit nr. 84/2016 – për subjektin e rivlerësimit, znj. Ledina Lera, nuk janë paraqitur denoncime nga publiku.
149. Gjithashtu ka rezultuar se nga vlerësimi i dosjeve dhe të dhënave të përcjella nga KLP-ja, nuk ka pasur ankesa të paraqitura për subjektin e rivlerësimit nga publiku, ndër vite, në Prokurorinë e Përgjithshme, me përjashtim të materialit hetimor të regjistruar nr.***, më 16.4.2018, për veprën penale “shpërdorim detyre”, për të cilën është marrë vendim i mosfillimit datë 25.4.2018.
150. Lidhur me ekzistencën e mundshme të ndonjë konflikti të interesit, Komisioni iu drejtua Prokurorisë pranë Gjykatës së Rrethit Gjyqësor Tiranë me shkresën nr. *** prot., datë 6.7.2020, duke kërkuar informacion lidhur me çdolloj çështje penale të shqyrtuar nga Prokuroria, me prokurore subjektin e rivlerësimit dhe personave juridikë/fizikë, lidhur me të cilët, përgjatë hetimit administrativ kishte rezultuar ekzistenca e ndonjë marrëdhënieje interesi me të. Prokuroria pranë Gjykatës së Rrethit Gjyqësor Tiranë me shkresën nr. *** prot., datë 23.7.2020, konfirmoi se nuk rezulton se subjekti i rivlerësimit, znj. Ledina Riza, të ketë shqyrtuar ndonjë procedim penal në ngarkim të shtetasve/personave të cituar në shkresë.
151. Gjithashtu, përgjatë hetimit administrativ nuk ka rezultuar që të jetë paraqitur ndonjë denoncim nga publiku për subjektin e rivlerësimit, znj. Ledina Riza, por ndërkohë është

depozituar vetëm një kërkesë me nr. *** prot., datë 23.7.2020, nga shtetasi E. D., e cila është analizuar nga Komisioni. Konkretisht është konstatuar se kërkesa në fjalë kishte si objekt heqjen nga kërkimi të personit kërkues, pasi sipas tij, vendimi penal nr. ***, datë 16.10.2019, i Gjykatës së Rrethit Gjyqësor Tiranë, që e ka shpallur fajtor për kryerjen e veprës penale të parashikuar nga neni 102 i Kodit Penal dhe dënimin e tij me 5 vjet burg, nuk ka marrë ende formë të prerë – për sa kohë ky i fundit e ka ankimuar brenda afateve ligjore prej 15-ditësh, sipas dispozitave ligjore që parashikon neni 410 i Kodit të Procedurës Penale. Në këto kushte, ai i është drejtuar disa herë Prokurorisë së Rrethit Gjyqësor Tiranë me shkresat e datave 13.5.2020 dhe 10.1.2020, por nuk ka marrë asnjë përgjigje.

152. Komisioni, lidhur me sa më lart, iu drejtua Prokurorisë së Rrethit Gjyqësor Tiranë me shkresën nr. *** prot., datë 11.11.2020, duke i kërkuar informacion lidhur me procedurat e ekzekutimit të vendimit penal nr. ***, datë 16.10.2019. Kjo e fundit, me shkresën nr. *** prot., datë 20.11.2020, vuri në dispozicion kopje të praktikës së urdhëranulimit të ekzekutimit të vendimit nr. ***, datë 16.10.2019. Nga shqyrtimi i dokumentacionit ka rezultuar se subjekti i rivlerësimit, në datën 15.9.2020, ka njoftuar shtetasin E. D. për anulimin e ekzekutimit, duke bashkëlidhur edhe praktikën e ardhur nga Gjykata e Apelit Tiranë, shkresën nr. *** prot., datë 23.7.2020.
153. Nga analizimi i dokumentacionit të sipërpërmendur rezultoi se subjekti i rivlerësimit nuk ka qenë prokuror⁷⁹ për ekzekutimin e vendimit, por ka qenë në rolin e Drejtuesit të Seksionit, e cila ka firmosur praktikën përcjellëse dhe informuese denoncuesit dhe organeve kompetente.
154. Shtetasi E. D., në kërkesën e tij, nuk përshkruan ndonjë shkelje procedurale nga subjekti i rivlerësimit apo moszbatim të detyrave funksionale, por pretendon zbardhjen e vendimit për heqjen nga kërkimi. Megjithatë, Komisioni i ka kërkuar shpjegime subjektit të rivlerësimit lidhur me këtë kërkesë.
155. Subjekti i rivlerësimit, pasi u njoh me rezultatet e Komisionit lidhur me këtë pikë, ka dhënë shpjegime, lidhur me dinamikën e çështjes, duke bërë me dije, veç të tjerash se: *“[...] Sa i përket aspektit profesional dua të vë në vëmendje se: ‘[...] Nga verifikimi i praktikës nga ana ime, rezulton se konkluzioni i trupës për këtë rast është shumë i saktë. Unë nuk kam qenë prokurorja që kam trajtuar drejtpërsëdrejti këtë praktikë dhe nuk kam nxjerrë as urdhrin për ekzekutimin e vendimit penal nr. ***, datë 16.10.2019, të Gjykatës së Rrethit Gjyqësor Tiranë dhe as urdhrin për anulimin e ekzekutimit të këtij vendimi (të dyja janë nxjerrë nga prokurorë të tjerë, të cilët në bazë të nenit 25/2 të Kodit të Procedurës Penale janë të pavarur në ushtrimin e funksionit të tyre). Në datën 15.9.2020, nga ana ime, me cilësinë e drejtueses së seksionit është firmosur një përgjigje për ankuesin E. D., lidhur mesa ai kërkonte, së bashku me një kopje të urdhrin për anulimin e ekzekutimit të vendimit. Në rastin konkret, sikurse në çdo rast tjetër gjatë ushtrimin të detyrës jam përpjekur të respektoj pavarësinë e prokurorit, të jem sa më korrekte dhe e paanshme në zbatimin e ligjit procedural penal, të respektoj afatet procedurale dhe veçanërisht të jem maksimalisht e përgjegjshme dhe e kujdesshme për të respektuar të drejtat dhe liritë e shtetasve”.*
156. Gjithashtu, lidhur me këtë çështje, subjekti ka paraqitur dokumentacionin si vijon:
- a. praktika për ekzekutimin e vendimit penal në ngarkim të të dënuarit E. B.;

⁷⁹ Urdhri i datës 5.11.2019, është lëshuar nga prokurori E. B., ndërsa urdhri për anulimin e ekzekutimit të vendimit penal nr. ***, datë 26.10.2019, i datës 28.7.2020 është dhënë nga prokurori A. Z.

- b. urdhrin nr. *** prot., datë 22.6.2010, për ekzekutimin e vendimit penal firmosur nga prokurore Ledina Riza; njoftimin e shtetasit E. B.; njoftimin e Gjykatës së Rrethit Gjyqësor Tiranë;
 - c. kërkesën për asgjësimin e provës materiale “lëndë narkotike”, drejtuar Drejtorisë së Përgjithshme të Policisë së Shtetit Tiranë;
 - d. urdhrin nr. *** prot., datë 22.6.2010 për asgjësimin e lëndës narkotike;
 - e. urdhrin për ekzekutimin e vendimit penal lidhur me shpenzimet procedurale në ngarkim të të dënuarit E. B.
157. Nisur nga sa më lart, Komisioni nuk ka konstatuar problematika lidhur me këtë praktikë, që mund të ndikojnë në vlerësimin e aftësive profesionale të subjektit të rivlerësimit, për sa kohë nuk rezultojnë elemente konkrete apo rrethana specifike faktiko-procedurale, që mund të çojnë në konkluzionin se ka pasur ndonjë shkelje procedurale nga subjekti i rivlerësimit apo mosrespektim të të drejtave të palëve.
158. Nga kryerja e një vlerësimi të përgjithshëm të kriterit të aftësive profesionale, trupi gjykues çmon se nisur nga gjendja faktiko-ligjore e konstatuar dhe e argumentuar më lart, si dhe nga konstatimet lidhur me mënyrën e të punuarit (modus operandi) të subjektit, nuk kanë rezultuar problematika që mund të klasifikohen si shkelje apo mangësi profesionale të subjektit të rivlerësimit. Për rrjedhojë, në konkluzion, trupi gjykues çmon se nisur nga rrethanat e sipërpërshkuara, subjekti i rivlerësimit, znj. Ledina Lera, ka arritur nivel kualifikues në vlerësimin e aftësive profesionale, sipas parashikimeve ligjore përkatëse.

KONKLuzion Përfundimtar

Trupi gjykues, sipas parashikimit të germës “a”, të nenit 59/1, të ligjit nr. 84/2016, arrin në përfundimin se subjekti i rivlerësimit, znj. Ledina Lera:

- a. ka arritur një nivel të besueshëm në vlerësimin e pasurisë;
- b. ka arritur një nivel të besueshëm në kontrollin e figurës;
- c. ka arritur një nivel kualifikues në vlerësimin e aftësive profesionale.

Në këto kushte, bazuar në provat që disponon në vlerësimin e çështjes në tërësi, si dhe në bindjen e brendshme, trupi gjykues arrin në konkluzionin që subjekti i rivlerësimit, znj. Ledina Lera, duhet të konfirmohet në detyrë.

Për këto arsye,

Trupi gjykues i Komisionit të Pavarur të Kualifikimit, bazuar në pikën 5, të nenit 55, të ligjit nr. 84/2016, pasi u mblodh në dhomë këshillimi, në prani të vëzhguesit ndërkombëtar, në bazë të nenit 58, pika 1, germa “a” dhe neni 59, pika 1, e ligjit nr. 84/2016, “Për rivlerësimin kalimtar të gjyqtarëve dhe prokurorëve në Republikën e Shqipërisë”,

V E N D O S I:

1. Konfirmimin në detyrë të subjektit të rivlerësimit, znj. Ledina Lera, prokurore në Prokurorinë pranë Rrethit Gjyqësor Tiranë.
2. Vendimi, i arsyetuar me shkrim, i njoftohet subjektit të rivlerësimit, Komisionerit Publik dhe vëzhguesve ndërkombëtarë dhe publikohet në faqen zyrtare të Komisionit, në përputhje me pikën 7, të nenit 55, të ligjit nr. 84/2016.
3. Ky vendim mund të ankimohet në Kolegjin e Posaçëm të Apelit nga Komisioneri Publik dhe/ose subjekti i rivlerësimit 15 ditë nga data e njoftimit të vendimit të Komisionit.
4. Ankimi depozitohet në Komisionin e Pavarur të Kualifikimit.

Ky vendim u shpall në datën 5.3.2021.

ANËTARËT E TRUPIT GJYKUES

Suela ZHEGU
Kryesuese

Lulzim HAMITAJ
Relator

Etleda ÇIFTJA
Anëtare

Sekretare gjyqësore
Orjanda Liçi